

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
SHQIPËRI

PROGRAMI I INTEGRUAR
I MËSIMIT SHQIP NË DIASPORË

Tiranë, korrik 2010

Grupi i punës:

1. Prof.dr. Ardian Marashi (kryetar)
2. Prof.dr. Gjovalin Shkurtaj
3. Prof.as.dr. Aljula Jubani
4. Akad. Vasil Tole
5. Prof.dr. Miaser Dibra
6. Prof.dr. Dhimitër Doka
7. Dr. Ndriçim Mehmeti
8. Ma. Yllka Spahiu

Ndihmuan:

1. Ma. Evis Mastori
2. Prof. dr. Erlehta Mato
3. Ma. Majlinda Hala
4. Prof.as.dr. Natasha Xhafka

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1. Hyrja
2. Synimi
3. Objektiva të përgjithshëm
4. Nivelet, aftësitë gjuhësore, linjat integrale
5. Objektiva sipas niveleve
6. Objektiva sipas aftësive gjuhësore dhe linjave
7. Udhëzime për zbatimin e programit
8. Vlerësimi i nxënësve
9. Plani mësimor
10. Burime të rekomanduara të të nxënit

1. HYRJA

Nevoja për të hartuar një program mësimor për gjuhën dhe kulturën shqiptare, për t'u shërbyer fëmijëve dhe të rinjve me origjinë shqiptare, familjet e të cilëve, për shkaqe të ndryshme, kanë zgjedhur të jetojnë jashtë Shqipërisë dhe trojeve shqiptare, ka kohë që është bërë mjaft e ndjeshme. Për këtë arsye, Ministri i Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Shqipërisë urdhëroi ngritjen e një komisioni me specialistë të mirënjohur të fushave albanologjike, të cilët, në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit, përpiluan këtë program mësimor, ku gjuha, historia, kultura dhe jeta shqiptare i paraqiten nxënësit në mënyrë të integruar, nga njëri mësim në tjetrin dhe nga cikli i ulët në ciklet më të larta.

Programi nuk ka për qëllim që ta zëvendësojë shkollimin e natyrshëm të nxënësit në gjuhën e vendit pritës, ku ai dhe familja e tij jetojnë prej vitesh. Përkundrazi, programi synon që ta plotësojë shkollimin e rregullt të fëmijëve me origjinë shqiptare, duke u ofruar këtyre një shkollim plotësues për shqipen dhe për kulturën e vendit të origjinës. Në varësi të mundësive dhe të angazhimit të mësuesve dhe të prindërve shqiptarë, shkollimi plotësues i fëmijëve mund të realizohet periodikisht me një ose me dy pasdite në javë, për një vëllim total prej 76 mësimesh në një cikël shkollimi, ose afërsisht 26 mësimet në një vit shkollor, çka korrespondon me një mësim të ri për çdo javë të vitit akademik në sistemin shkollor evropian. Vëmë në dukje se brenda një mësimi të vetëm, nxënësi merr njohuri mbi letërsinë dhe artin, historinë dhe gjeografinë, kulturën dhe zakonet, si dhe fiton shprehje gjuhësore për t'i kuptuar dhe për t'i shprehur në mënyrë korrekte njohuritë dhe aftësitë që i propozohen.

Në përputhje me grupmoshën, secili mësim zhvillon te nxënësi shprehje gjuhësore të përshtatshme, duke e aftësuar atë gradualisht që të kuptojë çfarë flitet përreth tij (të dëgjuarit); të dijë të përgjigjet, të japë mendim ose t'i drejtohet dikujt (të shprehurit); të punojë me tekstet dhe me librat shqip (të lexuarit); e, gjithashtu, të hartojë ai vetë, në mënyrë përherë e më të saktë, tekste tipologjish të ndryshme dhe detyra të tjera (të shkruarit). Grupmoshat zhvillohen në tri nivele mësimore, duke respektuar nivelet e shkollimit të sistemit evropian: niveli fillestar (klasat I-III ose mosha 6-9 vjeç), niveli ndërmjetës (klasat IV-VI ose mosha 9-12 vjeç), niveli i mesëm (klasat VII-IX ose moshat 12-15 vjeç). Programi mbetet i hapur për t'u plotësuar së shpejti edhe me nivelin e lartë (klasat X-XII ose moshat 15-18 vjeç), i cili do të mund të përpilohet duke u mbështetur në përvojën e zbatimit praktik të tri niveleve të tashme, si dhe në sugjerimet e mësuesve e të prindërve lidhur me vështirësitë e hasura.

Programi shtjellohet në 3 linja orientuese, të cilat, gjithashtu, konceptohen në mënyrë të integruar njëra me tjetrën:

- a) *Identiteti shqiptar*. Përmes kësaj linje, fëmija zbulon gradualisht dhe natyrshëm pjesën më të qenësishme të identitetit të vet të origjinës, gjuhën shqipe me veçoritë e saj fonetike dhe morfosintaksore, zotërimi i së cilës e aftëson atë që të punojë me tekste letrare dhe joletrare, në të cilat përvijohen konturet e pastaj format më të plota të përbërësve themelorë të identitetit kombëtar shqiptar.
- b) *Shqiptarët në hapësirë dhe kohë*. Përmes kësaj linje, nxënësi njihet me koordinatat dhe me hartën e vendosjes hapësinore të shqiptarëve, si dhe me momentet kryesore të përshkimit historik të tyre përgjatë shekujve. Kjo linjë e aftëson fëmijën që të orientohet në mënyrë graduale, duke zotëruar të dhënat kryesore që lidhen me gjeo-historinë shqiptare, me popullin shqiptar si formacion etnik dhe si njësi kombëtare.
- c) *Shoqëria dhe kultura*. Kjo linjë bashkërendon të dhënat dhe njohuritë e domosdoshme për shoqërinë shqiptare, për doket dhe traditat e saj zakonore, me dijen për trashëgiminë materiale e kulturore, për besimet e objektet e kultit, për monumentet e kulturës, parqet natyrore, vendet turistike etj.

Është e nevojshme të theksohet se linjat orientuese shërbejnë si kuadër i përgjithshëm dhe i përbashkët në të cilin realizohet integrimi i moduleve mësimore, meqenëse në praktikë ora mësimore nuk zhvillohet për lëndë e njohuri të veçanta, por kombinon materialin e disa lëndëve e të disa njohurive së bashku, në përputhje me qëllimin global që synon ky program: t'u mundësojë fëmijëve të familjeve shqiptare në diasporë që, krahas formimit të rregullt shkollor që këta marrin në vendet dhe në kulturat ku jetojnë, të marrin edhe njohuri e dije të sistemuara për shqipen, Shqipërinë e shqiptarët, me qëllim që të aftësohen qysh herët dhe në rrugë sa më të natyrshme për të mos u ndier të huaj në një mjedis shqiptar, e madje për t'u integruar pa vështirësi në të, nëse kjo dëshirë do t'u shfaqet.

Nga kjo perspektivë, “shkolla shqipe e mësimin plotësues” u shërben jo vetëm fëmijëve me origjinë shqiptare, por edhe gjithë nxënësve joshqiptarë që shfaqin interes të qëndrueshëm për gjuhën, kulturën dhe njeriun shqiptar. Nga ana tjetër, duke qenë se kompetenca për gjuhët vlerësohet si një ndër përparësitë e zhvillimit individual e kolektiv në epokën moderne të shumëgjuhësisë, kur shoqëritë dhe vendet përreth po orientohen drejt afirmimit të dy a më shumë gjuhëve zyrtare, zotërimi korrekt i gjuhës së origjinës përfillet si një element i rëndësishëm i formimit kurrikular, po edhe i personalitetit të individit të lindur në një mjedis gjuhësor familjar të ndryshëm nga ai i vendit të shkollimit. Botuesit, autorët dhe mësimdhënësit, të cilët do të punojnë me këtë program të mbajnë parasysh tri gjëra themelore në aspektin didaktik dhe të metodikave:

- 1) Brenditë e këtij programi, të ndërlihdura me njëra-tjetrën dhe të integruara në njëra-tjetrën, evoluojnë në përputhje me tri nivelet moshore, duke u plotësuar në atë mënyrë që rritja të jetë e dukshme, po edhe e natyrshme, nga niveli fillestar në nivelet pasardhëse, si dhe duke ofruar për çdo rast tekste e materiale didaktike-kulturore që u përgjigjen moshës së nxënësve edhe pritjes së mësuesve.
- 2) Është e domosdoshme që programi të materializohet në elemente pedagogjiko-mësimore të ndryshme, me qëllim që nxënësi e mësimdhënësi të kenë mbështetje didaktike sa më të plotë. Programi të zhvillohet në tri mjete mësimore të dallueshëm nga njëri-tjetri, e që mund të jenë:
 - a) teksti i nxënësit, në të cilin jepen të sistemuara dijet e kërkuara në program;
 - b) fletorja e punës, e cila, në kushtet e një funksionimi kryesisht vullnetar të shkollës, i siguron mësimdhënësit dhe prindërit se detyrat minimale do të përmbushen nga fëmija në mënyrë korrekte e sistematike;
 - c) materiali multimedial në format DVD, i konceptuar si material ndihmës i domosdoshëm për shkollën shqipe të mësimin plotësues.
- 3) Autorët dhe metodistët që do të merren me materializimin e programit, lipset të mbajnë parasysh se ky program nuk e zëvendëson shkollimin bazë që marrin nxënësit në sistemin arsimor të vendeve të tyre, por thjesht propozon dije plotësuese për mësimin shqip, me destinim kryesor fëmijët me origjinë shqiptare. Në këtë perspektivë, materialet mësimore dhe didaktike lipset të fokusohen jo aq në trajtimet dhe në problematikat teorike, sesa në aspektin praktik të të nxënësve, duke privilegjuar mësimin interaktiv, zbavitës e formues. Kjo qasje do t'u mundësojë mësimdhënësit që, në përputhje me formimin e tyre vetjak dhe me përvojat metodike individuale, t'u përshtaten rrethanave konkrete të mjedisit mësimor dhe tipologjisë së grupit të nxënësve, sipas vendeve ku këta jetojnë e shkollohen.

Së fundi, programi ofron një formim të zgjeruar të subjekteve mësimore sipas niveleve, por është e domosdoshme që ky formim shkollor të vijojë të plotësohet në terren, me ndihmën e prindërve, të cilët i krijojnë fëmijës një mjedis gjuhësor shqiptar në gjirin e familjes, e sidomos mundësojnë që fëmija të motivohet më tepër, nëpërmjet vizitës së vendit të origjinës dhe marrëdhënieve të drejtpërdrejta e të natyrshme që vetë fëmija vendos në kësi rastesh.

2. SYNIMI I PROGRAMIT

Programi i integruar i mësimi shqip në diasporën shqiptare synon që nxënësit:

- të mbajnë gjallë gjuhën shqipe dhe vetëdijen e përkatësisë etnike dhe të origjinës shqiptare në vend të huaj;
- ta ndiejnë vetën krenarë me identitetin kombëtar shqiptar dhe ta ushqejnë e ta ruajnë edhe më tej atë, nëpërmjet mësimi të gjuhës, si dhe me anë të njohjes me trashëgiminë e thesarit kulturor, natyror e historik kombëtar të shqiptarëve, si pjesë përbërëse e qytetërimit evropian e botëror;
- të ushtrojnë e të pasurojnë shprehitë ligjërimore në gjuhën shqipe (me shkrim e me gojë) në të gjitha mjediset dhe rrethanat e mundshme të komunikimit;
- të vetëdijesohen se gjuha shqipe dhe kultura shqiptare jo vetëm nuk i pengon, por edhe ua lehtëson integrimin në shoqërinë ku jetojnë, sepse sot Evropa dhe mbarë bota po orientohen kah bashkëjetesa, shumëgjuhësia dhe shumëkulturorësia;
- të mbajnë gjallë dituritë dhe njohjen e shqipes e të kulturës shqiptare, mundësisht edhe t'i shtojnë ato, me qëllim që, nëse u krijohen kushtet dhe mundësitë e nevojshme, eventualisht edhe ta kenë të lehtë kthimin në atdheun e origjinës dhe integrimin në shoqërinë e sotme shqiptare.

3. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM TË PROGRAMIT

Në përfundim të këtij programi, nxënësit duhet:

- të shtojnë njohuritë e tyre për gjuhën shqipe, të zotërojnë të lexuarit dhe të shkruarit rrjedhshëm;
- të njohin dhe të ushtrojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit të pavarur e të rrjedhshëm, si dhe të aftësohen për të kuptuar e vlerësuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- të shijojnë dhe të ndiejnë përmbajtjen dhe vlerat kulturore të teksteve dhe materialeve të ndryshme, duke e pasur këtë si ndihmë e mbështetje për brumosjen dhe shprehjen e identitetit shqiptar dhe si pasurim të kulturës individuale;
- të pasurojnë shprehitë ligjërimore (me shkrim e me gojë) në përshtatje me mjedisin dhe tematikën përkatëse (sipas parimit “Kush flet, me kë, ku, kur, për çfarë, në cilin variant gjuhësor”);
- të njohin shtrirjen territoriale, etnike e kombëtare të shqiptarëve, si dhe dukuritë kryesore fiziko-gjeografike, mjedisore, ekonomiko-shoqërore e humane të tyre;
- të njohin dhe vlerësojnë historinë e kombit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, lidhur me zhvillimet historike botërore dhe të vendit ku ata jetojnë;
- të njohin konceptet bazë, vlerat dhe kategoritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore shqiptare, rrugët e mbrojtjes së saj, për t'u bërë të vetëdijshëm për origjinën, vendin nga vijnë, traditat dhe kulturën e vendit të origjinës;
- të njihen me jetën dhe veprat e shqiptarëve të shquar në rrjedhë të kohërave, përfaqësues të historisë evropiane, artit, të letërsisë, të shkencës;
- ta duan dhe të jenë krenarë për vendin e origjinës, për shqiptarët kudo ndodhen, pavarësisht nga ndarjet në shtete të ndryshme e pengesat kufitare, ndryshimet dhe veçoritë kulturore, ekonomike, fetare etj;

- të kuptojnë rolin dhe përgjegjësinë që kanë si individë në botën globale ku jetojmë;
- të ndërgjegjësohen se e ardhmja e popullit shqiptar është rruga e integritit dhe e bashkëpunimit rajonal, evropian dhe botëror.

4. NIVELET, AFTËSITË GJUHËSORE DHE LINJAT INTEGRUESE

Programi i integruar për mësimin plotësues në diasporën shqiptare është hartuar sipas tri niveleve, katër aftësive gjuhësore dhe tri linjave integruese bazë.

Nivelet janë:

1. Niveli i parë – klasat I-III
2. Niveli i dytë – klasat IV-VI
3. Niveli i tretë – klasat VII-IX.

Aftësitë gjuhësore janë:

1. Të dëgjuarit
2. Të folurit
3. Të lexuarit
4. Të shkruarit.

Linjat integruese janë:

1. Identiteti shqiptar
2. Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë
3. Kultura dhe shoqëria.

5. OBJEKTIVA SIPAS NIVELEVE

Niveli i parë: klasat I-III

Në përfundim të këtij niveli, synohet që nxënësit:

- të aftësohen për komunikim fillestar dhe të drejtë në gjuhën letrare shqipe për temat e ndryshme, përmes bisedës, përshkrimit gojor dhe formave artistike të të shprehurit (recitime, dialogë dhe këngë në përputhje me moshën dhe me interesat e tyre);
- të aftësohen për shkrim e lexim themelor, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit të gjuhës shqipe;
- t'i zhvillojnë kompetencat gjuhësore në nivel të përdorimit fillestar dhe të ngjiten shkallë-shkallë në zotërimin e kompetencës gjuhësore të niveleve më ta larta;
- të aftësohen të ndërtojnë drejt fjalitë e thjeshta dhe të dallojnë fjalët e ndryshueshme në gjuhën standarde shqipe;
- të përdorin forma të ndryshme të të shprehurit krijues përmes prezantimeve, bisedave, këngëve, vizatimeve apo punëve krijuese për tema e për situata të ndryshme;
- të përjetojnë bukurinë e këngës shqipe, duke kënduar dhe dëgjuar disa nga këngët e propozuara ose edhe të tjera;
- të dëgjojnë dhe të përjetojnë vepra muzikore të kompozitorëve shqiptarë nga repertori i zgjedhur i krijimtarisë muzikore kombëtare;
- të njohin disa nga veprat artistike të krijuesve shqiptarë, përfaqësues të arteve pamore, muzikore etj., dhe t'i ndërlidhin ato me njësitë tematike të caktuara;

- t'i njohin e t'i përvetësojnë termat, nocionet dhe konceptet themelore historike, gjeografike e kulturore të shoqërisë shqiptare, duke u nisur nga koncepti për familjen e deri te koncepti për atdheun.

Niveli i dytë: klasat IV-VI

Në përfundim të këtij niveli, synohet që nxënësit:

- të zhvillojnë shkathhtësitë e komunikimit (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit) në gjuhën standarde shqipe dhe të aftësohen t'i zbatojnë drejt këto, në situata të ndryshme;
- të zhvillojnë kompetencat gjuhësore në fushat e drejtshqiptimit, drejtshkrimit si dhe të organizimit logjik të tekstit letrar ose joletrar;
- t'i zhvillojnë kompetencat gjuhësore në nivel të përdorimit të pavarur;
- të kuptojnë drejt marrëdhëniet e shqipes standarde me dialektet dhe me ligjërimet jostandarde;
- të jenë në gjendje të dallojnë ndryshimet ndërmjet gjuhës standarde dhe varianteve jostandarde ose dialekteve të shqipes;
- të zhvillojnë aftësitë për të shprehur përjetimet, përshtypjet, qëndrimet, shqetësimet, gjykimet dhe vlerësimet, nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit me gojë e me shkrim, si dhe përmes formave të shprehjes artistike muzikore e figurative;
- të krahasojnë krijimet artistike në letërsi, muzikë dhe arte figurative nga autorët e vendit të origjinës dhe të vendit ku jetojnë, për të parë karakteristikat dalluese dhe të përbashkëta mes tyre;
- të paraqesin, të diskutojnë e të përshkruajnë ngjarje, vende dhe figura të rëndësishme historike kombëtare, duke përdorur e hulumtuar të dhëna e burime të ndryshme;
- të njohin pozitën dhe shtrirjen natyrore e gjeografike të vendit të origjinës në kontekstin e sotëm ballkanik, rajonal e evropian;
- të njohin dhe të kuptojnë aspektet themelore të organizimit shoqëror e shtetëror të vendit të origjinës dhe t'i dallojnë veçantitë e tyre.

Niveli i tretë: klasat VII-IX

Në përfundim të këtij niveli, synohet që nxënësit:

- të lexojnë, të kuptojnë dhe të zbërthejnë e të vlerësojnë tekste informative-publicistike dhe letrare;
- të përvetësojnë dhe të zbatojnë të shkruarit e drejtë e kompetent në gjuhën shqipe letrare;
- t'i zhvillojnë kompetencat gjuhësore në nivel mesatar e të lartë të përdorimit ligjërimor;
- të jenë në gjendje të përkthejnë tekste nga gjuha shqipe në gjuhën e vendit ku jetojnë dhe anasjelltas;
- të zbatojnë konkretisht dijet për gjuhën e letërsinë shqipe dhe të dëshmojnë për aftësinë e përdorimit të gjuhës shqipe në të gjitha veprimtaritë gjuhësore;
- të lexojnë, të komentojnë e të interpretojnë autorët e veprat përfaqësuese të letërsisë shqiptare dhe t'i krahasojnë këta me letërsinë e vendit ku jetojnë dhe me atë evropiane e botërore;
- të dëgjojnë e të komentojnë veprat më përfaqësuese të krijimtarisë muzikore shqiptare dhe t'i krahasojnë këto me vlerat muzikore të vendit ku jetojnë dhe me ato evropiane e botërore;

- të njohin, të vlerësojnë e të komentojnë veprat më përfaqësuese të krijimtarisë shqiptare të arteve pamore dhe t'i krahasojnë me vlerat e artit pamor të vendit ku jetojnë dhe me ato evropiane e botërore;
- të njohin e të vlerësojnë trashëgiminë kulturore kombëtare dhe ta krahasojnë këtë me atë të vendit ku jetojnë;
- t'i kuptojnë veçoritë fizike-gjeografike dhe shkallën e zhvillimit shoqëror e ekonomik në atdhe dhe lidhjet e këtij zhvillimi me vendin ku jetojnë dhe më gjerë;
- të kuptojnë dhe t'u qasen në mënyrë kritike proceseve, ngjarjeve dhe zhvillimeve historike kombëtare shqiptare në raport krahasues me shoqërinë e vendit ku jetojnë dhe me zhvillimet globale.

6. OBJEKTIVA SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE DHE LINJAVE INTEGRUESE

Objektivat sipas aftësive gjuhësore dhe linjave integruese janë shkruar në dukje sipas lëndëve të veçanta: *gjuhë shqipe dhe letërsi, histori, gjeografi, trashëgimi*. Realisht, këtu bëhet fjalë për një program të vetëm “lëndor”, ku lëndët shikohen të integruara, përmes përmbajtjeve dhe objektivave të tyre. Është detyrë e mësuesit dhe e hartuesit të teksteve e të materialeve mësimore që ta realizojë integrimin e tyre.

NIVELI I PARË (KLASAT I-III)

1. GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI - Përdorimi elementar i gjuhës		
Aftësia: TË DËGJUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të dëgjuarit përnjohës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dëgjimi i bisedave të ilustruara, i tregimeve, përrallave, legjendave etj. ▪ Dëgjimi i himnit kombëtar. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësi të dëgjojë dhe të kuptojë gjëra të thjeshta; ▪ Të respektojë folësin dhe të hyjë në bashkëbisedim me të.
Të dëgjuarit efektiv	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dëgjimi aktiv i të tjerëve që flasin për tema me rëndësi jetësore (shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi ku jeton etj.); ▪ Dëgjimi i temave për shëndetin, mjedisin, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, dukuritë e natyrës, historinë e njerëzimit në përgjithësi dhe të kombit shqiptar në veçanti. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dëgjojë të tjerët dhe të dallojë tiparet ose timbret e ndryshme në të folurit e tyre; ▪ Të kuptojë konceptin e kohës (dje, sot, nesër); dhe hapësirës (këtu, atje, andej, këndeje, para, mbropa); ▪ Të zhvillojë të dëgjuarit aktiv gjatë rrëfimeve të të tjerëve.
Të dëgjuarit e bisedave dhe teksteve joletrare e letrare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Biseda të karakterit njohës, kujtime, rrëfime moralizuese ose didaktike, dokumentar shkencor popullarizues, mjedisor, etik, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket e zakonet, për sportin, muzikën etj.); ▪ Tekste letrare të formave të thjeshta (fjalë të urta, këngë, legjenda, përrallëza, përralla, gjëegjëza), vjersha popullore dhe poezi, prozë dhe pjesë dramatike të shkurtra. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë dallimet e bisedave dhe teksteve joletrare nga tekstet letrare; ▪ Të dallojë karakterin shprehës e teksteve joletrare; ▪ Të dëgjojë dhe dallojë ritmin e rimën e poezisë; të dallojë vargun dhe strofën veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike.
Të dëgjuarit që synon përvetësimin e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe; ▪ Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe përdorimi i drejtë i tyre (emri, mbiemri, përemri, folja); 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dallojë të shqiptuarit e zanoreve dhe bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe; ▪ Të dallojë bashkëtingëlloret njëshkronjëshe nga bashkëtingëlloret dyshkronjëshe; ▪ Të zgjedhjë e të formojë fjali me format e foljeve ndihmëse kam e jam në tri kohët kryesore; ▪ Të dallojë emrat e përveçëm nga emrat

	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i gjuhës në tekstet me dialogë, dallimi i fjalisë dëftore dhe pyetëse. 	<p>e përgjithshëm, të ndërtojë fjali me format e plota të përemrave vetorë;</p> <ul style="list-style-type: none"> Të dallojë fjalinë dëftore nga fjalia pyetëse, mbështetur në intonacionin e zërit.
Aftësia: TË FOLURIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të folurit përnjohës dhe kumtues	<ul style="list-style-type: none"> Paraqitja e vetes, anëtarëve të familjes së ngushtë dhe të rrethit më të gjerë, prejardhjes; Përshkrimi i portretit fizik personal (emërtimi i pjesëve të trupit të njeriut), i ditëve të javës, muajve dhe stinëve të vitit. Simbolet kombëtare dhe shtetërore (flamuri kombëtar shqiptar, flamuri shtetëror i Republikës së Shqipërisë dhe i Republikës së Kosovës, himni dhe emblema; harta e Shqipërisë, harta e Kosovës). 	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi të paraqesë veten dhe të tjerët në kuptimin e njohjes së ndërsjellë; Të aftësohet të flasë e të komunikojë qartë me të tjerët; Të zhvillojë kulturën e të folurit si tipar i sjelljes së hijshme.
Të folurit aktiv në grup	<ul style="list-style-type: none"> Paraqitje gojore për tema me rëndësi jetike (familja, farefisi, shkolla, mësimi, ndarja e punëve sipas moshës, koha e lirë, argëtimi, mjedisi jetësor, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet; forcat natyrore: tërmeti, vullkani, era, stuhia, shiu, bora, breshri; luftërat, etj.); Komunikimi në largësi (telefon, faks, internet dhe forma tjera). 	<ul style="list-style-type: none"> Të zotërojnë të folurit bindës e argumentues për temat e caktuara që zhvillohen brenda grupit; Të përvetësojnë mënyrat e përfshirjes në bisedat e gjalla dhe në bashkëbisedimet në grup; Të ushtrojnë dhe të realizojë etikën dhe respektin në komunikim me të tjerët gjatë përdorimit të teknologjisë komunikative bashkëkohore (Alo, urdhëroni, ju lutem, po, si urdhëroni; kush jeni ju; si quheni, ju lutem?).
Të folurit e zakonshëm dhe ligjërimi letrar	<ul style="list-style-type: none"> Tekste joletrare: nxënësi prezanton gojarisht tekste joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, mjedisor, etik, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende dhe popuj, gjuhë të ndryshme; figura historike, sport, muzikë, etj.); Tekste letrare të thjeshta (fjalë të urta, këngë, legjenda, përrallëza, përralla, gjëgjëza). Poezi, prozë dhe pjesë dramatike. 	<ul style="list-style-type: none"> Të dallojë larinë dhe tiparet kryesore të teksteve joletrare; Të kuptojë dallimet mes teksteve joletrare dhe teksteve letrare; Të dallojë poezinë nga proza; Të dallojë ritmin e poezisë dhe të prozës, dialogun.
Të folurit që synon	<ul style="list-style-type: none"> Shqiptimi i tingujve zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës 	<ul style="list-style-type: none"> Të përvetësojë të shqiptuarit e tingujve zanorë e bashkëtingëllorë karakteristik

përvetësimin e gjuhës	<p>shqipe;</p> <ul style="list-style-type: none"> Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe përdorimi i drejtë i tyre (folja, emri, mbiemri, përemri); Gjuha në tekstet me dialogë (njeh dhe dallon fjalitë dëftore dhe pyetëse). 	<p>për gjuhën shqipe; fjalë me <i>th, dh, ll, sh, zh, q, gj, ç, xh</i>;</p> <ul style="list-style-type: none"> Të dallojë: përdorimin e foljeve ndihmëse kam e jam në tri kohët kryesore, emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm, përemrat vetorë; mbiemrat e nyjshëm e të panyjshëm; Mbështetur në intonacionin e zërit, të dallojë fjalinë dëftore nga ajo pyetëse.
Aftësia: TË LEXUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të lexuarit fillestar	<ul style="list-style-type: none"> Leximi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve (karakteristike për gjuhën shqipe); Leximi i fjalëve në rrokje, fjalëve të plota dhe togfjalëshave; Leximi i fjalive të thjeshta dhe i teksteve të shkurtra. 	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi të kuptojë dhe dallojë shqiptimin e shenjave të alfabetit të gjuhës shqipe duke bërë dallimin nga shkronjat e alfabetit të gjuhës së shtetit ku jeton; Të kuptojë natyrën e shqiptimit të rrokjeve, fjalëve e fjalive të thjeshta.
Të lexuarit e teksteve joletrare dhe letrare	<ul style="list-style-type: none"> Leximi i teksteve joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, mjedisor, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende, popuj dhe gjuhë të ndryshme; figura historike, sport, muzikë etj.); Tekste letrare të thjeshta (fjalë të urta, poezi popullore, legjenda, përrallëza, përralla, gjëgjëza); poezi, prozë dhe pjesë dramatike. 	<ul style="list-style-type: none"> Të dallojë të lexuarit mes teksteve joletrare nga tekstet letrare; Të dallojë karakterin e teksteve joletrare; Të dallojë poezinë nga proza; Të lexojë dhe të dallojë ritmin e poezisë e të prozës dhe pjesëve dramatike; Të zhvillojë të lexuarit përmes monologut e dialogut.
Të lexuarit që synon përvetësimin e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e vendore në tekste të ndryshme (dallimet); Fjalja e thjeshtë dhe ndërtimi i saj. Fjalitë dëftore, pyetëse, mohore. 	<ul style="list-style-type: none"> Të dallojë gjuhën standarde nga të folmet krahinore e lokale; Të kuptojë fjalinë e thjeshtë dhe ndërtimin e saj; Të lexojë rrjedhshëm tekste me fjali të thjeshta.
Të lexuarit që synon njohjen e teknikave të leximit	<ul style="list-style-type: none"> Leximi pa zë ose leximi në heshtje; Leximi me zë: leximi shprehës, leximi gradual, recitimi. 	<ul style="list-style-type: none"> Të mësojë dy format kryesore të leximit: leximin pa zë ose në heshtje dhe leximin me zë; Të përvetësojë rrjedhshmërinë e shkallëzimit rritës (progresiv) të leximit aktiv dhe të recitimit.
Aftësia: TË SHKRUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të shkruarit fillestar	<ul style="list-style-type: none"> Shenjat e pikësimit: pika, presja, pikëpresja, apostrofi, dy pikat në gjuhën shqipe. 	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi të zotërojë shkrimin e drejtë të grafemave dyshe karakteristike për gjuhën shqipe (<i>th, dh, sh, zh, xh</i>); Të përdorë drejt shkronjat e mëdha në

	<ul style="list-style-type: none"> Shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla. 	<p>emrat e përveçëm dhe në fillim fjalie;</p> <ul style="list-style-type: none"> Të kuptojë praninë e grupeve të bashkëtingëlloreve në shqip (<i>mb, nd, ng, ngj</i>) dhe të togjeve zanore (<i>ua, ue, ye, ie</i>). Të mësojë ndarjen e fjalëve në rrokje.
Të shkruarit normativ	<ul style="list-style-type: none"> Të shkruarit drejt të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve të shqipes; Përshkrimi (në formë elementare) i sendeve, njerëzve, objekteve; Kopjimi i fjalive dhe teksteve të shkurtra joletrare mbi bazën e modeleve: ftesa, falënderime, urime për ditëlindje, për festa kombëtare, për festa e ditë të shënuara familjare; njoftime; plotësim formularësh, faturash etj.; Kopjimi i teksteve letrare dhe shkrimi i biografive, autobiografisë, letrave, ditarit, vjershave, tregimeve, korrespondencave etj. 	<ul style="list-style-type: none"> Të përvetësojë shkrimin e zanoreve e bashkëtingëlloreve të shqipes, fjalëve dhe fjalive të thjeshta; Të zhvillojë shkrimin komunikues (shkrimi i përshëndetjeve, i urimeve, falënderimeve, ftesave, njoftimeve, e të tjera të kësaj natyre); Të krijojë të shkruajë për nevoja vetjake sipas modeleve dhe të zhvillojë shkrimin krijues (diktime dhe hartime të thjeshta me tema të paracaktuara).
Të shkruarit që synon përvetësimin e njohurive gjuhësore	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi gjatë shkrimit i foljeve ndihmëse kam e jam në tri kohët kryesore; Emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm; Përemrat vetorë në njëjës dhe në shumës; Fjalitë e thjeshtë dëftore dhe fjalitë pyetëse. 	<ul style="list-style-type: none"> Të zotërojë tri kohët kryesore të foljeve (e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja); Të kuptojë qartë dallimin e emrave të përveçëm nga emrat e përgjithshëm; Të bëjë dallimin e përemrave vetorë sipas vetave; Të zotërojë shkrimin e fjalive të thjeshta dëftore dhe pyetëse.
Të shkruarit që synon përvetësimin e drejtshkrimit dhe shenjave të pikësimit	<ul style="list-style-type: none"> Shkronjat e mëdha si shenjë e emrave të përveçëm dhe e fillimit të fjalisë. Shkronjat me dy grafema, shkronja e madhe pas pikës si dhe zanorja -ë; Shenjat e pikësimit: pika, presja, pikëpyetja, pikëçuditja. 	<ul style="list-style-type: none"> Të zotërojë shkrimin e shkronjave të përbëra prej dy grafemave të veçanta në gjuhën shqipe (<i>gj, ll, sh, zh, th, dh</i>); Të përvetësojë dallimin e shkronjave, shkronjat -e dhe -ë në shqipen (<i>vera-vëra</i>); Të përvetësojë përdorimin e shkronjës së madhe në fillim fjalie dhe në emrat e vendeve, njerëzve etj.; Të përvetësojë përdorimin e shkronjës zanore -ë në emrat e gjinisë femërore (punë, vajzë, arrë); Të përdorë drejt në fjali shenjat e pikësimit (pika, presja, pikëpyetja, pikëçuditja).
2. HISTORI		
Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI		<i>Nxënësi:</i>

SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pema e familjes sime, puna e prindërve të mi në vendlindje dhe në vendin ku jetoj; ▪ Traditat, festat kombëtare dhe zyrtare të Atdheut. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përshkruajë vendin e të parëve dhe të tij/saj; ▪ Të paraqesë veten, prejardhjen në breza, familjen dhe rolin e saj në jetën shoqërore.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Qyteti, vendi ku unë jetoj tani. Vendi i lindjes së të parëve të mi. Si kemi jetuar dhe si jetojmë tani. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krahasojë qytetin, vendin ku jeton; tani, me atë ku ka jetuar më parë.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të ndryshëm, por të barabartë. Të përbashkëtat dhe dallimet, veçoritë e shokëve të shkollës sime dhe unë. Bota, pjesë e jetës sime. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të identifikojë ndryshimet dhe të përbashkëtat në komunitetin ku jeton. ▪ Të paraqesë veten si pjesë e botës që e rrethon.

3. GJEOGRAFI

Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendi i prejardhjes së të parëve të mi: Shqipëria, Kosova, trevat e tjera shqiptare; ▪ Vendlindja e të parëve të mi: prindërit, gjyshja, gjyshi (fshati, qyteti, krahina, rajoni). 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përshkruajë vendin e prejardhjes së të parëve, veçoritë gjeografike të tij vendndodhjen,(fushat, malet, luginat, detet etj); ▪ Të përdorë harta, vizatime, fotografi për të treguar vendin e prejardhjes me tiparet dalluese të tij.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Veçoritë natyrore të trevave shqiptare (relievi, klima, ujërat, bimët, kafshët, bukuritë natyrore). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krahasojë peizazhin natyror të vendit të prejardhjes dhe atij të banimit, duke identifikuar tiparet e përbashkëta dhe të veçanta; ▪ Të përdorë ilustrime të ndryshme që shprehin bukurinë natyrore të trevave shqiptare.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prejardhje e ndryshme, jetë e përbashkët. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të japë shembuj të jetës së përbashkët dhe të të drejtave të njëjta, pavarësisht nga vendi i prejardhjes.

4. TRASHËGIMI

Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Himni i flamurit</i>, simbol kombëtar; ▪ Lojërat popullore shqiptare; ▪ Rrënjët e mia dhe të 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të këndojë <i>Himnin e flamurit</i> solo ose në grup, duke respektuar solemnitetin e himnit; ▪ Të luajë disa lojëra popullore shqiptare për fëmijë; ▪ Të zhvillojë veprimtari të ndryshme artistike, sportive, etnografike, gatime të traditës shqiptare; ▪ Të njohë dhe të përdorë vegla muzikore popullore shqiptare, përmes modeleve të

	<p>familjes sime;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Veglat muzikore popullore shqiptare (lahuta, fyelli /çiftelia / sharkia/ qypi/ këmborët/ zilet/ pipëzat...); ▪ Këngët tradicionale dhe të kultivuara për fëmijë; ▪ Mjedisi dhe peizazhi shqiptar; ▪ Veshjet popullore shqiptare; ▪ Mozaik vizatimor me motive tradicionale shqiptare. 	<p>thjeshta ritmike dhe melodike;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vizatojë veglën muzikore të parapëlqyer në familjen dhe mjedisin e tij më të ngushtë; ▪ Të njohë disa nga veprimtaritë tradicionale kombëtare për fëmijë si: festivalet e këngës për fëmijë; ▪ Të mësojë këngë të thjeshta në përputhje me moshën e tij; ▪ Të vizatojë objekte mjedisore dhe kulturore të Shqipërisë të vizituara ose të para me DVD; ▪ Të krijojë albume me foto ose kartolina nga Shqipëria të bëra vetë ose duke i nxjerrë nga interneti; ▪ Të dallojë veshjet popullore shqiptare përmes veprimtarive të ndryshme folklorike, albumeve etnografike /katalogëve /DVD; ▪ Të vizatojë motive të thjeshta popullore si motive qilimi, qylafët, jelekët popullore, fustanellat, duke evidentuar ngjyrat, simbolikën dhe karakteristikat e tyre.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqipëria përmes trashëgimisë shpirtërore; ▪ Figurat e shquara të historisë shqiptare. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vizatojë ose të fotografojë pamje me motive të mjedisit familjar dhe nga jeta në Shqipëri; ▪ Të njohë figurën e Skënderbeut dhe Nënë Terezës nëpërmjet tregimeve, pjesëve historike të thjeshta, filmave, DVD-ve, pikturave etj.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përralla, gjëgjëza, fjalët e urta, fjalëshpejtat dhe lojërat e këngët; ▪ Festat tradicionale - dita e verës. ▪ Këngët legjendare shqiptare –figurat mitologjike në epikën legjendare; ▪ Muzika popullore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të tregojë dhe të interpretojë përralla popullore shqiptare, si: e Bukura e Dheut, Qerosi, Gishtoja etj; ▪ Të përshkruajë festat shqiptare, ritin e ditës së verës me këngët, vallet, veshjet dhe gatimet e saj speciale si ballokumet; ▪ Të njohë figurat legjendare, si: Muji e Halili, Gjergj Elez Alia, Orët, Zanat etj; ▪ Të vizatojë figurën legjendare shqiptare më të parapëlqyeshme; ▪ Të këndojë këngë me shumë zëra dhe me një zë.

NIVELI I DYTË (Klasat IV-VI)

1. GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI - Përdorimi i pavarur i gjuhës		
Aftësia: TË DËGJUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë për nxënësin:
Të dëgjuarit përnjohës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dëgjuarit e të tjerëve dhe mënyrat e të shprehurit për temat që trajtojnë; ▪ Të dëgjuarit e rrëfimeve nga familjarët dhe të afërmit për vendlindjen, atdheun, përkatësinë kombëtare e fetare si njohje e të kaluarës së largët dhe të afërt; ▪ Të dëgjuarit e himnit kombëtar dhe himnit të shtetit ku jeton. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dëgjojë dhe të kuptojë atë që thonë mësuesi ose folës të tjerë në klasë e në mjediset shkollore; ▪ Të ketë vëmendje ndaj atyre që flasin me të, t'i respektojë dhe të dialogojë me ta në mënyrë normative; ▪ Të zbatojë rregullat gjatë intonimit të himneve.
Të dëgjuarit efektiv	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dëgjuarit aktiv të të tjerëve që flasin për tema të caktuara (shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi jetësor); ▪ Të dëgjuarit e temave për mjedisin, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat etj.; ▪ Të dëgjuarit dhe të kuptuarit e rëndësisë së institucioneve vendimmarrëse. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dëgjojë të tjerët dhe të dallojë të folurit e tyre; ▪ Të kuptojë idenë e kohës dhe të përdorë në fjali ndajfoljet përkatëse (dje, sot, nesër); ▪ Të kuptojë idenë e vendit dhe të përdorë në fjali ndajfoljet përkatëse (këtu, atje, aty, këtu, para, mbrapa); ▪ Të zhvillojë të dëgjuarit aktiv gjatë rrëfimeve të të tjerëve; ▪ Të zhvillojë kulturën e të dëgjuarit si mundësi argumentimi, bindjeje, qartësie dhe komunikimi të ndërsjellë.
Të dëgjuarit e bisedave dhe teksteve letrare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dëgjuarit e teksteve joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, mjedisor, etik, edukativ e historik (si për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, për hapësirën urbane dhe bukuritë natyrore nga kanë ardhur dhe ku jetojnë, për sportin, muzikën etj.); ▪ Të dëgjuarit e teksteve letrare të formave të thjeshta (fjalë të urta, këngë, legjenda, përrallëza, përralla, gjëgjëza); poezi, prozë 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë dallimet e teksteve joletrare nga tekstet letrare; ▪ Të dallojë poezinë nga proza; ▪ Të dëgjojë dhe të dallojë ritmin e poezisë; veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike; ▪ Të kuptojë lidhjen që ka një tekst me muzikën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike.

	dhe pjesë dramatike.	
Të dëgjuarit që synon përvetësimin e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme (folja, emri, mbiemri, përemri, numërori, ndajfolja, lidhëza etj.); ▪ Gjuha standarde dhe të folmet krahinore vendore (dallimet); ▪ Përdorimi i gjuhës në tekstet me dialogë dhe diferencimi (dallimi) i fjalive të thjeshta dëftore, nxitëse, pyetëse si dhe i kryefjalës e kallëzuesit brenda tyre; ▪ Fjalitë e përbërë dhe ligjëratat. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme; ▪ Të kuptojë gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore dhe vendore; ▪ Mbështetur në intonacionin e zërit, të dallojë qartë fjalinë e thjeshtë, fjalinë e përbërë, ligjëratën e drejtë nga e zhdrejta.
Aftësia: TË FOLURIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të folurit përnjohës ose kumtues	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prezantimi i vetes, anëtarëve të familjes së ngushtë dhe të gjerë, prejardhjes; ▪ Prezantimi i vendlindjes së vet, të prindërve dhe të afërmeve; ▪ Paraqitja e Atdheut në kohë dhe hapësirë dhe simbolet kombëtare e shtetërore (flamuri, himni, stema etj.). 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të zotërojë të folurit për komunikim të qartë me të tjerët; ▪ Të zhvillojë kulturën e të folurit si shprehje e komunikimit të qartë dhe të bukur.
Të folurit aktiv në grup	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Paraqitjet gojore për tema të caktuara (shkolla, mësimi, ndarja e punëve sipas moshës, koha e lirë, argëtimi, mjedisi ku jeton, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat; etj.); ▪ Biseda për rëndësinë e institucioneve vendim-marrëse në jetën publike, për pasuritë natyrore dhe ekonomike të vendeve nga kanë ardhur dhe ku jetojnë; ▪ Komunikimi në largësi (telefon, faks, internet, celular dhe forma tjera). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të zotërojë të folurit bindës e argumentues për temat e caktuara që zhvillohen brenda grupit; ▪ Të përvetësojë të folurit aktiv në bashkëbisedim dhe në grup; ▪ Të përvetësojë mënyra e qasje të të folurit në komunikim me të tjerët gjatë përdorimit të teknologjisë përnjohëse (telefon, internet etj.);
Të folurit në funksion të teksteve joletrare dhe letrare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prezantimi gojarisht i teksteve joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, mjedisor, etik, 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë dallimet e teksteve joletrare nga tekstet letrare;

	<p>edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende dhe figura historike, për hapësirën urbane dhe bukuritë natyrore nga kanë ardhur dhe ku jetojnë, për sportin, muzikën etj.);</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Tekste letrare: fjalë të urta, këngë, legjenda, përrallëza, përralla, gjëegjëza, poezi, prozë dhe pjesë dramatike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dallojë karakterin e teksteve joletrare; ▪ Të dallojë poezinë nga proza; ▪ Të dëgjojë dhe të dallojë ritmin e poezisë; veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike; ▪ Të zhvillojë të folurit shprehës përmes dialogëve; ▪ Të kuptojë lidhjen që ka një tekst me muzikën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike..
<p>Të folurit që synon përvetësimin e gjuhës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme (folja, emri, mbiemri, përemri, numërori, ndajfolja, lidhëza); ▪ Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e vendore (dallimet); ▪ Fjalitë e thjeshta dëftore, nxitëse, pyetëse; ▪ Kryefjala dhe kallëzuesi; ▪ Fjali e përbërë dhe ligjëratë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dallojë fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme; ▪ Të kuptojë gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore dhe vendore; ▪ Mbështetur në intonacionin e zërit, të dallojë qartë fjalinë e thjeshtë, fjalinë e përbërë, ligjëratën.
<p>Aftësia: TË LEXUARIT</p>	<p>Përmbajtja mësimore</p>	<p>Objektiva të aftësisë</p>
<p>Të lexuarit e teksteve joletrare dhe letrare</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tekste joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, mjedisor, etik, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende dhe figura historike, për hapësirën urbane dhe bukuritë natyrore nga kanë ardhur dhe ku jetojnë, për sportin, muzikën etj.); ▪ Tekste letrare të formave të thjeshta: fjalë të urta, poezi popullore, legjenda, përrallëza, përralla, gjëegjëza; poezi, prozë dhe pjesë dramatike nga letërsia shqipe. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dallojë tekstet joletrare nga tekstet letrare; ▪ Të kuptojë dallimet brenda teksteve joletrare; ▪ Të dallojë poezinë nga proza; ▪ Të lexojë dhe të dallojë ritmin e poezisë, veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike; ▪ Të zhvillojë të lexuarit përmes dialogëve; ▪ Të kuptojë lidhjen që ka një tekst me muzikën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike.
<p>Të lexuarit që synon përvetësimin e gjuhës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale (dallimet) në tekste të ndryshme; ▪ Fjalitë e thjeshtë, fjalitë e përbërë dhe ligjëratë, si 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë shenjat e pikësimit dhe përdorimin e tyre në tekste; ▪ Të dallojë fjalinë e thjeshtë, fjalinë e përbërë dhe ligjëratën, mbështetur në intonacion dhe shenja të pikësimit.

	dhe shenjat e pikësimit të përdorura brenda tyre.	
Të lexuarit që synon përvetësimin e teknikave të leximit	<ul style="list-style-type: none"> Leximi me zë: leximi shprehës, leximi gradual, recitimi, interpretimi (diksioni, intonacioni, ndalesat, shenjat e pikësimit, timbri, tempi i leximit etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> Të përvetësojë rrjedhshmërinë e gradualitetit të leximit aktiv, të recitimit dhe të interpretimit.
Aftësia: TË SHKRUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të shkruarit normativ	<ul style="list-style-type: none"> Përshkrimi i njerëzve, objekteve, sendeve; Kopjimi i fjalive dhe teksteve të shkurtra joletrare mbi bazën e modeleve (ftesa, falënderime, njoftime); Plotësimi i formularëve, faturave; Shkrimi i pyetjeve, anketave, intervistave etj.); Kopjimi i teksteve letrare dhe shkrimi i biografisë, autobiografisë, letrës, ditarit, vjershës, tregimit, korrespondencës etj. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të zhvillojë shkrimin komunikues (shkrimi i urimeve, mirënjohjeve, ftesave, njoftimeve, raporteve të shkurtra dhe të tjera të kësaj natyre etj.); Të krijojë dhe të shkruajë për nevoja vetjake sipas udhëzimeve të mësimdhënësit apo modeleve dhe të zhvillojë shkrimin subjektiv.
Të shkruarit që synon përvetësimin e njohurive gjuhësore	<ul style="list-style-type: none"> Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme; Folja: zgjedhimi në kohët e mënyrës dëftore dhe lidhore; Emri: llojet, gjinia; Mbiemri: llojet, gjinia; Përemri: llojet; Numërori, ndajfolja, lidhëza; Fjalitë e thjeshta dëftore, nxitëse, pyetëse; Gjymtyrët kryesore të fjalisë (kryefjala, kallëzuesi); <p>Fjalë e përbërë. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe me nënrenditje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Të zhvillojë njohuritë për fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme; përmes zgjedhimit, përkatësisht lakimit. Të njohë tipat kryesore të fjalisë së thjeshtë dhe llojet e fjalisë së përbërë, si dhe gjymtyrët kryesore të tyre (kryefjala, kallëzuesi).
Të shkruarit që synon përvetësimin e drejtshkrimit dhe shenjave të pikësimit	<ul style="list-style-type: none"> Shkronja e madhe pas pikës, në fillim dhe brenda fjalisë; Shkrimi me vend i zanores ë dhe i bashkëtingëlloreve gj, xh, q, ç etj.; Shenjat e pikësimit: pika, 	<ul style="list-style-type: none"> Të zotërojë përdorimin e shkronjës së madhe; Të përvetësojë përdorimin e zanores ë dhe të bashkëtingëlloreve gj, xh, q, ç; <p>Të përvetësojë dhe të përdorë drejt shenjat e pikësimit, si: pikën, presjen, pikëçuditjen, pikëpyetjen dhe dy pikat, përmes shkrimit</p>

	presja, pikëçuditja, pikëpyetja dhe dy pikat.	të teksteve të ndryshme.
--	---	--------------------------

2. HISTORI

Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Populli shqiptar, origjina, shtrirja gjeografike; ▪ Shqiptarët si pjesë e Ballkanit dhe Evropës. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përshkruajë origjinën, shtrirjen gjeografike të popullit shqiptar duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni; ▪ Të paraqesë të dhëna që dëshmojnë për shqiptarët si njëri ndër popujt më të vjetër të Ballkanit dhe të Evropës; ▪ Të përshkruajë marrëdhëniet e shqiptarëve me fqinjët dhe me popujt e tjerë të Evropës.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Paraardhësit: ilirët, shtrirja e tyre dhe fiset kryesore; ▪ Mesjeta, nga Arbrit tek shqiptarët; ▪ Organizimi shtetëror i shqiptarëve. Festat kombëtare dhe fetare; ▪ Figura të historisë kombëtare dhe më gjerë mbretërit ilirë: Bardhyli, Genti, Agroni, Teuta, Skënderbeu, Ali Pashë Tepelena, Ismail Qemali, Ahmet Zogu, Nënë Tereza, Ismail Kadare dhe të tjerë të kohës moderne. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përcaktojë shtrirjen në kohë të fiseve ilire; ▪ Të rreshtojë argumente që dëshmojnë vazhdimësinë historike iliro-arbërore-shqiptare; ▪ Të evidentojë aftësinë shtetformuese të shqiptarëve, që nga mbretëritë e para ilire deri te shteti i pavarur i Kosovës; ▪ Të përshkruajë disa ndër personalitetet që kanë lënë gjurmë në zhvillimin, historik, kombëtar, kulturor dhe social të shqiptarët.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bota - familje e madhe ku jam pjesëtar edhe unë. ▪ Të drejtat dhe detyrimet universale të njerëzimit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të identifikojë karakteristikat dalluese të popujve të ndryshëm, si: raca, origjina, feja, gjuha, kultura etj.; ▪ Të identifikojë disa nga të drejtat dhe detyrimet që vlejné për të gjithë njerëzit pa dallim.

3. GJEOGRAFI

Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pozicioni gjeografik i trevave shqiptare në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe botës. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krahasojë pozicionin gjeografik të trevave shqiptare me vendin e banimit; ▪ Të përshkruajë rolin e pozitës gjeografike të trevave shqiptare në marrëdhëniet me vendet e tjera të rajonit e më gjerë.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Larmia dhe diversiteti i natyrës së trevave 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krahasojë veçoritë kryesore gjeografike (relievin, klimën, hidrografinë, botën bimore e shtazore) të

	<p>shqiptare;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Popullsia në trevat shqiptare; ▪ Veçoritë e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare. 	<p>trevave shqiptare me atë të banimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të tregojë në hartë format kryesore të relievit, rrjetin hidrografik etj.; ▪ Të përshkruajë ndikimin e njeriut në mjedisin natyror dhe anasjelltas, ndikimin e mjedisit natyror në veprimtarinë e njeriut; ▪ Të përshkruajë elementet (karakteristikat) kryesore demografike të popullsisë së trevave shqiptare (numrin e popullsisë, shtimin natyror, strukturën e popullsisë); ▪ Të evidentojë tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare në raport me vendin ku jeton.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identiteti natyror dhe human i trevave shqiptare në kushtet e globalizimit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përshkruajë disa nga vlerat natyrore e historiko-kulturore të trevave shqiptare (veçoritë dalluese në gjuhë, në besim: tolerancë fetare, marrëdhënie ndëretnike).

4. TRASHËGIMI

Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kënga legjendare dhe historia; ▪ Këngët patriotike; ▪ Shqipëria dhe traditat e saj nëpërmjet krijimit popullor; ▪ Vallet tradicionale shqiptare; ▪ Tradita e zakone të lindjes dhe dasmës në Shqipëri; ▪ Veshjet popullore shqiptare sipas krahinave; ▪ Muzika popullore; ▪ Iso-polifonia me dy, tre dhe katër zëra. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vlerësojë dashurinë e madhe që ka karakterizuar familjen shqiptare për njëri-tjetrin nëpërmjet këngës së Gjergj Elez Alisë; ▪ Të njohë dhe të këndojë disa këngë patriotike në veprimtari të ndryshme, si p.sh. në Festën e Flamurit; ▪ Të tregojë larminë e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe të vlerave të tyre (gjuha, veshja, loja, folklori gojor, muzikor dhe koreografik).; ▪ Të njohë dhe kërcëjë valle popullore shqiptare, duke respektuar karakteristikat e tyre; ▪ Të njohë karakteristikat e ritualeve të lindjes dhe të dasmës shqiptare nëpërmjet këngëve, valleve, veshjeve etj., (ninullat, këngët dhe vallet e dasmave etj.); ▪ Të improvizojë një ceremoni dasme shqiptare, duke u mbështetur në pikturën e Kol Idromenos “Dasma Shqiptare”; ▪ Të klasifikojë veshjet popullore shqiptare sipas funksionit dhe krahinave; ▪ Të kërkojë në internet veshje tipike popullore shqiptare sipas krahinave dhe të krijojë album me to; ▪ Të këndojë dhe të shprehë emocionet e tij/saj përmes këngëve popullore të vendlindjes; ▪ Të njohë rëndësinë e Iso-Polifonisë, si

		kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mitet dhe figurat mitologjike; ▪ Epika legjendare shqiptare; ▪ Emigracioni në këngët popullore shqiptare. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të shpjegojë mjetet dhe figurat mitologjike si formë e komunikimit të hershëm dhe si pasuri e sotme kulturore; ▪ Të japë shembuj nga historia dhe letërsia rreth miteve dhe figurave mitologjike; ▪ Të përshkruajë lirizmin në këngët legjendare përmes fragmentit “Bukuria e Tanushës”; ▪ Të njohë këngët popullore shqiptare të emigracionit; ▪ Të këndojë duke interpretuar një prej këtyre këngëve.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kënga legjendare dhe historia; ▪ Artizanati shqiptar dhe zejjet shqiptare; ▪ Gatime e pije shqiptare; ▪ Trashëgimia arkitekturore shqiptare; ▪ Përmendoret kryesore të kultit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të njohë kodin e besës shqiptare si element me vlerë i sjelljes dhe moralit shqiptar nëpërmjet legjendës “Besa e Kostandinit”; ▪ Të njohë mjeshtritë dhe mjeshtrit e ndryshëm të kulturës shqiptare si dhe produktet e tyre – punime bakri, argjendi, metali, punime me shtiza dhe grep etj.; ▪ Të njohë dhe të bëjë gatime të thjeshta tradicionale shqiptare – byreku, tava e dheut etj.; ▪ Të njohë llojet e ndërtimeve arkitekturore qytetare e fshatare shqiptare; ▪ Të vizatojë një objekt monumental shqiptar (kështjellë, urë, kullë etj.); ▪ Të bëjë dallimet midis kishave, xhamive, teqeve, duke shpjeguar lashtësinë dhe vlerat arkitektonike të tyre; ▪ Të vlerësojë larminë (diversitetin) e bashkëjetesës së feve në Shqipëri dhe tolerancën popullore fetare.

NIVELI I TRETË (Klasat VII-IX)

1. GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI - Përdorimi kompetent i gjuhës		
Aftësia: TË DËGJUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të dëgjuarit përnjohës	<ul style="list-style-type: none"> Të dëgjuarit e të tjerëve dhe mënyrat e të shprehurit për temat që trajtojnë, marrja e informatave dhe krahasimi i tyre. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Të dëgjojë dhe të kuptojë atë që flet; Të respektojë folësin dhe të dialogojë me të, të sqarojë dhe të argumentojë.
Të dëgjuarit efektiv	<ul style="list-style-type: none"> Të dëgjuarit aktiv të të tjerëve që flasin për tema të caktuara (shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi ku jeton, të drejtat dhe përgjegjësitë individuale e grupe brenda institucioneve); Të dëgjuarit aktiv të paraqitjeve të të tjerëve: qëndrimet dhe mendimet për shoqërinë bashkëkohore, dallimet etnike e fetare. 	<ul style="list-style-type: none"> Të dëgjojë të tjerët dhe të dallojë të folurit e tyre; Të zhvillojë të dëgjuarit aktiv gjatë rrëfimeve të të tjerëve; Të zhvillojë kulturën e të dëgjuarit si mundësi argumentimi, bindjeje, qartësie dhe komunikimi reciprok.
Të dëgjuarit e bisedave dhe teksteve letrare	<ul style="list-style-type: none"> Tekste joletrare gazetash, revistash dhe emisionesh televizive (reportazhe, intervista, anketa etj.); Tekste letrare nga autorë të huaj (poetë, prozatorë, dramaturgë). 	<ul style="list-style-type: none"> Të dallojë mënyrat e informimit në shtyp dhe televizion; Të kuptojë dallimet mes letërsisë shqipe dhe asaj të huaj; Të kuptojë lidhjen që ka letërsia me muzikën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike.
Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale (dallimet); Përdorimi i gjuhës në tekstet me dialogë; Figurshmëria dhe semantika e fjalës në tekste të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> Të kuptojë gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore e lokale; Të kuptojë semantikën e fjalëve brenda fjalisë, periudhës dhe tekstit; Të dallojë kuptimin figurativ të gjuhës.
Aftësia: TË FOLURIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të folurit përnjohës ose kumtues	<ul style="list-style-type: none"> Identiteti im (prejardhja, përkatësia, gjeneza); Prezantimi i vendlindjes, atdheut në kohë dhe hapësirë dhe i simboleve kombëtare e shtetërore (flamuri, himni, stema, shenjat e figurat emblematike identifikuese 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Të zotërojë të folurit për komunikim të qartë me të tjerët; Të zhvillojë kulturën e të folurit si përgjegjësi e komunikimit të qartë.

	kombëtare e shtetërore).	
Të folurit aktiv në grup	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pjesëmarrja aktive në biseda dhe debate që zhvillohen në grup për tema të caktuara paraprakisht, të cilat janë me interes; ▪ Biseda për rëndësinë e institucioneve vendim-marrëse në jetën publike, funksionimin e tyre dhe pjesëmarrjen në to; ▪ Shfaqja e mendimeve dhe mbajtja e qëndrimeve lidhur me problemet e shoqërisë bashkëkohore, për dallimet etnike si pasuri njerëzore; ▪ Komunikimi në distancë (telefon, internet dhe forma tjera). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të zotërojnë të folurit bindës e argumentues për temat e caktuara që zhvillohen brenda grupit; ▪ Të përvetësojnë të folurit aktiv në bashkëbisedim dhe në grup; ▪ Të përvetësojnë mënyra e qasje të të folurit në komunikim me të tjerët gjatë përdorimit të teknologjisë përnjohëse (telefon, internet etj.);
Të folurit në funksion të teksteve joletrare dhe letrare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Diskutimi për llojet e shkrimeve gazetareske; ▪ Mitologjia si formë e komunikimit të hershëm dhe si pasuri e sotme; ▪ Analiza dhe komentimi i poezisë, prozës dhe pjesës dramatike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë dallimet e formave të shkrimeve gazetareske; ▪ Të komentojnë tekste dhe figura të mitologjisë shqiptare dhe të krijimeve të tjera me shtresime mitologjike (përrallat, legjendat, baladat, këngët e kreshnikëve etj.); ▪ Të kuptojë ngjashmëritë dhe dallimet që kanë tekstet letrare si në formë
Të folurit që synon përvetësimin e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale (afritë dhe dallimet); ▪ Fjalja e përbërë, ligjëratat, paragrafi, teksti. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore dhe lokale; ▪ Të dallojnë fjalinë e përbërë, ligjëratën, mbështetur në intonacionin e zërit.
Aftësia: TË LEXUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të lexuarit e teksteve joletrare dhe letrare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tekste joletrare gazetareske (informata, intervista, reportazhi); ▪ Tekste të krijimtarisë gojore (përrallat, figurat mitologjike, këngët e kreshnikëve); ▪ Dokumentet e para të shkrimit shqip; ▪ Autorë dhe vepra të letërsisë shqipe sipas zhvillimit të saj në kohë dhe në hapësirë: poezi, prozë, dramë (lloje të ndryshme). 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë strukturën e teksteve gazetareske; ▪ Të kuptojë esencat e mitologjisë shqiptare dhe të krijimeve të tjera; ▪ Të kuptojë figuracionin e poezisë (ritmi, metafora, simboli, krahasimi etj.); ▪ Të kuptojë veçoritë e prozës (subjekti, ideja kryesore, detaji, personazhi); ▪ Të kuptojë historinë e shkrimit shqip; ▪ Të kuptojë dialogun, monologun te pjesët dramatike dhe të komedisë.
Të lexuarit që synon	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjuha standarde dhe format dialektore; 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë afrinë dhe dallimet që kanë dialektet e shqipes në mes veti, si edhe

përvetësimin e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> Leximi i teksteve në dy dialektet e shqipes dhe në gjuhën standarde. 	me standardin e sotëm të shqipes.
Të lexuarit për përvetësimin e teknikave të leximit	<ul style="list-style-type: none"> Leximi i teksteve të ndryshme me zë: leximi shprehës, leximi gradual, recitimi, interpretimi, interpretimi në role (diksioni, intonacioni, ndalesat, shenjat e pikësimit, timbri, tempi i leximit etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> Të përvetësojë rrjedhshmërinë e gradualitetit të leximit aktiv, të recitimit dhe të interpretimit individual dhe të interpretimit në role dramatike.
Aftësia: TË SHKRUARIT	Përmbajtja mësimore	Objektiva të aftësisë
Të shkruarit funksional (zbatues) dhe subjektiv	<ul style="list-style-type: none"> Përshkrimi i njerëzve, objekteve, pamjeve natyrore e urbane; Kopjimi i paragrafëve dhe teksteve të shkurtra joletrare e letrare; Shkrimi i biografisë, autobiografisë, letrës, ditarit, vjershës, tregimit, korrespondencës, raportit, komentit, esesë etj. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të zhvillojë shkrimin komunikues përmes përshkrimit; Të krijojë dhe të shkruajë për nevoja vetjake sipas udhëzimeve të mësimdhënësit apo modeleve, si dhe të zhvillojë shkrimin subjektiv.
Të shkruarit që synon përvetësimin e njohurive gjuhësore	<ul style="list-style-type: none"> Fjala: sinonimet, antonimet, homonimet; Folja: zgjedhimi në kohët e mënyrës kushtore, habitore, etj.; Emri: lakimi, trajta, rasat; Mbiemri: shkallët, gjinia, lakimi; Përemri: lakimi, Numërori, ndajfolja, lidhëza, pjesëza, pasthirrma; Llojet e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje; Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë. 	<ul style="list-style-type: none"> Të zhvillojë njohuritë për fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme, përmes zgjedhimit dhe lakimit; Të kuptojë gjymtyrët e dyta të fjalisë, si: kundrinorin, rrethanorin, ndajshkrimin; Të kuptojë dhe të dallojë llojet e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje; Të kuptojë ligjëraten dhe të dallojë ligjëraten e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë.
Të shkruarit që synon përvetësimin e drejtshkrimit dhe shenjave të pikësimit	<ul style="list-style-type: none"> Shkronja e madhe pas pikës, në fillim dhe brenda fjalisë, tek emrat e përveçëm etj.; Shkrimi me vend i zanores ë dhe bashkëtingëlloreve gj, xh, q, ç, zh, th etj.; Shenjat e pikësimit: pika, presja, pikëpresja, pikëçuditja, pikëpyetja, dy pikat, viza lidhëse, tri pikat. 	<ul style="list-style-type: none"> Të zotërojë përdorimin e shkronjës së madhe; Të përvetësojë përdorimin e zanores ë dhe bashkëtingëlloreve gj, xh, q, ç, zh, th; Të përvetësojë dhe të përdorë drejt shenjat e pikësimit si: pikën, presjen, pikëpresjen, pikëçuditjen, pikëpyetjen, dy pikat, vizën lidhëse dhe tri pikat,

		përmes shkrimit të teksteve të ndryshme.
2. HISTORI		
Linja	Përmbajtja mësimore	Objektivat të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Origjina e popullit shqiptar; ▪ Vendi i të parëve tanë; ▪ Vendet ku jetojnë sot shqiptarët; ▪ Identiteti evropian i shqiptarëve. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të argumentojnë origjinën e ilirëve, arbërve dhe shqiptarëve, duke vlerësuar përpjekjet për identitet kombëtar; ▪ Të identifikojë hapësirat gjeografike ku jetojnë sot shqiptarët; ▪ Të rendisë argumente që mbështesin identitetin evropian të shqiptarëve.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Qendrat e qytetërimit të lashtë shqiptar: Lipjani (Ulpiana), Shkupi (Skoplje), Shkodra (Scodra), Durrësi (Dyrrah), Lezha (Lissus), Apolonia, Butrinti, Ulqini etj.; ▪ Gjetjet arkeologjike dhe faktet historike që vërtetojnë lashtësinë e shqiptarëve; ▪ Shteti i Arbrit, dhe i Skënderbeut në Mesjetë; ▪ Tiparet themelore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare; ▪ Shqiptarët gjatë shekullit XX; ▪ Lufta e shqiptarëve për pavarësi dhe emancipim kombëtar; ▪ Emigrimet shqiptare gjatë historisë dhe ndihmesa e shqiptarëve të diasporës për Atdheun. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të dallojë qytetet e vjetra kryesore të atdheut; ▪ Të përshkruajë vendndodhjen gjeografike dhe karakteristikat e tyre historike; ▪ Të identifikojë fakte historike- arkeologjike që flasin për lashtësinë e shqiptarëve; ▪ Të paraqesë organizimin e shtetit shqiptar dhe tiparet e tij nga Arbrit te Skënderbeu; ▪ Të vlerësojë përpjekjet dhe luftën e shqiptarëve për arsim kombëtar dhe pavarësi; ▪ Të përcaktojë periudhat historike të emigrimeve të shqiptarëve.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Personalitete historike dhe bashkëkohore shqiptare në zë për njerëzimin; ▪ Ndihmesa e shqiptarëve për bashkëpunim dhe integrim në botë; ▪ Qytetërimi ilir dhe ndihmesa e tij në kulturën e lashtë evropiane; ▪ Skënderbeu, roli i tij si mbrojtës i qytetërimit evropian; ▪ Nënë Tereza, shëmbëlltë e humanizmit botëror. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të tregojë rolin që ka luajtur dhe luan diaspora shqiptare në kultivimin e kulturës kombëtare dhe ruajtjen e identitetit tonë kombëtar; ▪ Të argumentojë ndihmesën e shqiptarëve për integrim në nivel ndërkombëtar; ▪ Të vlerësojë rolin e personaliteteve të kombit shqiptar gjatë historisë në fusha të ndryshme të kulturës, shkencës, mjekësisë, letërsisë dhe qytetërimit botëror.

3. GJEOGRAFI		
Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pasuritë e veçanta nëntokësore dhe mbitokësore të trevave shqiptare. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të ndërtojë hartën e pasurive nëntokësore që përmbajnë trevat shqiptare; ▪ Të evidentojë pasuritë e veçanta mbitokësore që përmbajnë trevat shqiptare (Alpet, Vargu i Korabit, Bjeshkët e Namuna, Lura, Liqenet, Bregdeti etj).
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE KOHË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizimi i veçantë administrativ i trevave shqiptare; ▪ Migrimi i shqiptarëve; ▪ Vendbanimet në trevat shqiptare; ▪ Ekonomia e trevave shqiptare; ▪ Mjedisi dhe turizmi i trevave shqiptare; ▪ Rajonet gjeografike të trevave shqiptare. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të identifikojë ndryshimet në organizimet administrativo-tokësore në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare, skemat aktuale administrative; ▪ Të përshkruajë historikun e migrimit të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në shkaqet dhe pasojat e tij.; ▪ Të evidentojë territoret ku kanë emigruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e integritetit të tyre; ▪ Të vlerësojë kontributin e emigrantëve në zhvillimin e vendit të prejardhjes; ▪ Të dallojë llojet e vendbanimeve sipas zonave gjeografike dhe të krahasojë arkitekturën e tyre në raport me vendin ku jeton; ▪ Të analizojë rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e trevave shqiptare (ekonominë bujqësore, industrinë, tregtinë, transportin, shërbimet); ▪ Të vlerësojë rëndësinë e pasurive natyrore dhe kulturore të trevave shqiptare për zhvillimin turistik të tyre; ▪ Të identifikojë ndarjen rajonale të trevave shqiptare dhe tipet e rajoneve.
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Trevat shqiptare si pjesë e integritetit evropian dhe botëror. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vlerësojë përmes një detyre tematike problemet aktuale dhe të ardhmen e zhvillimit të trevave shqiptare, duke i parë dhe trajtuar ato në kushtet e integritetit rajonal, evropian dhe botëror.
4. TRASHËGIMI		
Linja	Përmbajtja mësimore	Objektiva të linjës
IDENTITETI SHQIPTAR	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Himni i flamurit si simbol kombëtar; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të interpretojë dhe të njohë simbolikën e himnit kombëtar dhe rasteve a situatave

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kryevepra të trashëgimisë kulturore; ▪ Arti figurativ shqiptar; ▪ Kodikët dhe kanunet; ▪ Dita kombëtare e trashëgimisë kulturore; ▪ Institucionet e ruajtjes dhe të kujdesit të trashëgimisë popullore; ▪ Muzika kombëtare. 	<p>në të cilat dëgjohet ai, qëndrimin e atij që e këndon etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të marrë pjesë në një ekspeditë kërkimore arkeologjike në Shqipëri sipas “Listës botërore të monumenteve”, të mbrojtura nga UNESCO (në tokë dhe në det): Parku Kombëtar i Butrintit, Qytetet - muze të Gjirokastrës dhe të Beratit; të hulumtojë rreth tyre përmes internetit; ▪ Të njohë dhe të vlerësojë piktorë të ndryshëm gjatë shekujve, si: Onufri, Odise Paskali (Busti i Skënderbeut) Abdurrahim Buza (Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit), Ibrahim Kodra; ▪ Të njohë rolin që ka luajtur kanuni në Shqipëri si institucioni i parë ligjor popullor. Roli i Shtjefën Gjeçovit në mbledhjen e këtij kodi; ▪ Të njohë 29 Shtatorin si Ditën Kombëtare të trashëgimisë kulturore shqiptare; ▪ Të marrë pjesë individualisht ose në grup në udhëtime imagjinare ose virtuale në internet, në qytetet dhe kështjellat më të moçme të vendit: Shkodër, Krujë, Petrelë, Berat, Gjirokastrë, Durrës etj. duke njohur vlerat e tyre; ▪ Të realizojë një album me foto të zonave më të njohura të vendit; ▪ Të njohë rolet e institucioneve të ruajtjes dhe studimit të trashëgimisë kulturore shqiptare; ▪ Të përshkruajë disa nga monumentet që këto institucione kanë nën kujdesin e tyre; ▪ Të shpjegojë se çfarë janë festivalet folklorike kombëtare dhe vendore; ▪ Të njohë dhe të vlerësojë kompozitorët shqiptarë në shekuj, në veçanti autorin Çesk Zadeja (1927-1997), si krijuesin e shkollës muzikore kombëtare.
<p>SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË</p>	<p>Zhvillimi historik e kulturor;</p> <p>Historiku i fotografisë;</p> <p>Opera, simfonia dhe baleti;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shqipëria dhe shqiptarët përmes syrit të të huajve. 	<p>Të identifikojë përmes objekteve muzeale institucionet kulturore: Muzeu Historik Kombëtar (Tiranë), Muzeu i Artit Mesjetar (Korçë), Muzeu Onufri (Berat) etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të njohë pasuritë arkivore të fotografisë kombëtare. Fototeka “Marubi” (Shkodër); ▪ Të marrë pjesë në një ekspozitë me fotografi nga Shqipëria; ▪ Të dëgjojnë dhe të ndjekë përmes CD-ve apo DVD-ve operën e parë/ simfoninë e parë/ baletin e parë shqiptar; ▪ Të identifikojë këndvështrimin e të

		<p>huajve gjatë gjithë historisë së Shqipërisë nëpërmjet shkrimeve të historianëve, diplomatëve dhe artistëve të shquar, si: Bajron, Durham etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të ilustrojë praninë e tyre në Shqipëri. (<i>Shembull: Thomas Philips, “Bajroni me veshje popullore shqiptare”</i>).
KULTURA DHE SHOQËRIA	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Eposi shqiptar përkrah eposeve të vendeve të tjera; ▪ Balada; ▪ Parqet kombëtare arkeologjike; ▪ Turizmi shqiptar; <p>Mjedisi dhe peizazhi shqiptar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krahasojë ngjashmëritë dhe dallimet e eposit tonë nga ai i zonave të tjera të Evropës; ▪ Të përshkruajë baladën si legjendë dhe si realitet nëpërmjet pjesës “Kthimi i Ymer Agës”; ▪ Të njohë parqet kombëtare më të rëndësishme të vendit dhe të bëjë një guidë arkeologjike të Shqipërisë: Shkodra, Lezha, Apolonia, Bylisi, Amantia, Orikumi, Antigonea, Finiqi; ▪ Të njohë vendet më turistike të Shqipërisë nga jugu në veri: malet, bregdetet, liqenet, pyjet dhe çfarë ofrojnë ato për turistët etj.; ▪ Të dallojë nga fotot ose pikturat peizazh përmendoret e mjedisit shqiptar, si dhe parqet e mbrojtura me ligj nga shteti shqiptar e organizmat ndërkombëtarë.

7. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i integruar i mësimi shqip në diasporë është hartuar duke mbajtur parasysh plotësimin e disa standardeve të domosdoshme për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar nëpërmjet edukimit.

Zbatimi me sukses i programit varet nga faktorë socialë, ekonomikë, psikologjikë e gjuhësorë, të cilët mund të ndihmojnë ose edhe të pengojnë zbatimin e praktikave dhe të metodave formale të mësimdhënies. Por një mësues i devotshëm, krijues e pasionant, dhe profesionalisht i përgatitur, mund të dalë jashtë kornizave të mësimdhënies formale, për t'u krijuar nxënësve mjedis të këndshëm e stimulues, me qëllim që këta ta vazhdojnë përvetësimin e programit në mënyrë sistematike.

Metodat që duhet të përdorë mësuesi në zbatimin e programit duhet të jenë integruese, ndërvepruese dhe plotësuese të njëra-tjetrës. Ato duhet të marrin parasysh karakteristikat e niveleve moshore, nivelin fillestar të formimit gjuhësor e kulturor të nxënësve, mënyrat e tyre vetjake të të nxënësve, kushtet dhe mjediset e të nxënësve në shkollën shqipe dhe në shtëpi, mënyrat e të nxënësve në shkollat që ata frekuentojnë në vendin ku jetojnë, arsyet pse ndjekin këtë program etj. Mësuesi duhet të krijojë një atmosferë nxitëse dhe argëtuese për nxënësit, që këta ta konsiderojnë ndjekjen e shkollës shqipe si një “detyrim” që u sjell kënaqësi. Ata duhet ta ndiejnë mungesën e saj dhe, në një farë mënyre, ta shikojnë si plotësuese të shkollës që ndjekin në vendin ku jetojnë, si dhe mbushëse të veprimtarive të kohës së lirë të tyre. Kjo mund të arrihet nga një mësues i përgatitur profesionalisht, i dashur, i hapur dhe mirëkuptues për nevojat e fëmijëve për lojë e për argëtim, për mësim argëtues.

Hapi i parë që duhet të bëjë një mësues në zbatimin e programit është vlerësimi i nxënësve për nivelin e njohurive dhe të aftësive në “lëndët” që propozon programi. Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh objektivat e programit dhe është një vlerësim diagnostikues. Mbi bazën e të dhënave nga vlerësimi, mësuesi përcakton përmbajtjet mësimore, metodat e mësimdhënies, mjetet dhe materialet e mësimdhënies, metodat dhe teknikat e vlerësimit të nxënësve. Metoda mbizotëruese duhet të jenë metodat e bashkëbisedimit, kërkimore dhe krijuese, të nxënësve nëpërmjet projektdetyrave, veprimtaritë praktike, loja etj.

Programi i integruar i mësimi shqip në diasporë përbëhet nga përmbajtje mësimore të disa lëndëve, si: gjuhë shqipe dhe letërsi, histori, gjeografi, trashëgimi, të cilat integrohen fort me njëra-tjetrën. Integrimi realizohet në nivel horizontal dhe vertikal, nëpërmjet linjave integruese (të njëjtat linja integruese ruhen si brenda një niveli, ashtu dhe nga njëri nivel në tjetrin), gjë që mundëson koherencën dhe fleksibilitetin e zbatimit të programit. Kështu, p.sh., në linjën “Identiteti shqiptar” trajtohet “Himni i flamurit” në të gjitha “lëndët”. Ai mund të shfrytëzohet nga mësuesi dhe autorët të tekstit e materialeve mësimore në disa këndvështrime:

- gjuhësor (nxënësit dëgjojnë, shkruajnë, lexojnë, recitojnë poezinë, e interpretojnë atë me shkrim apo me gojë);
- letrar (përjetohet figura, kuptohet dallimi poezi-tregim, shijohet gjuha e poezisë, edukohet shija, zhvillohet kompetenca përkatëse etj.);
- të trashëgimisë (nxënësit mund të dëgjojnë, të këndojnë dhe interpretojnë në instrument muzikor, ose mund të vizatojnë, të ngjyrosin, të modelojnë flamurin, simbolet e tjera kombëtare etj.; ata mund të bisedojnë rreth ndonjë krijimi artistik, ku temë është flamuri ose ngjarjet konkrete rreth tij);
- historik (nxënësit mësojnë për flamurin dhe momentet historike të lidhura me të në periudha të ndryshme të historisë kombëtare);
- gjeografik (nxënësit mund të bisedojnë të mësojnë për qytetet ose rajonet e ndryshme të Atdheut të lidhura me momentet historike, pastaj mësuesi mund të organizojë

edhe temat vijuese si p.sh. përdorimi i flamurit në institucione zyrtare, në familje dhe në festa).

Zbatimi me sukses i programit mësimor varet dhe nga faktorë të tjerë, e jo vetëm nga dëshira e mirë dhe niveli profesional i mësuesit. Mësuesi duhet të mbështetet nga strukturat arsimore, profesionale, komunitare, të vendit ku jeton dhe të Atdheut. Roli i rrjeteve profesionale të arsimtarëve të diasporës shqiptare, por dhe i diasporave të tjera, i bordeve të prindërve, i komunitetit shqiptar, i institucioneve arsimore dhe i shkollave të vendit ku jetojnë, i institucioneve arsimore dhe i shkollave të Atdheut, është shumë i madh dhe i një rëndësie të veçantë për suksesin e programit. Bashkëpunimi me këto institucione dhe me partnerë duhet të bëhet i planifikuar dhe me strategji të qartë.

Në zbatimin e programit ndihmon dhe përgatitja e nxënësve në lëndët përkatëse në shkollat që ndjekin aktualisht fëmijët. Është mirë që mësuesi të njohë programet gjegjëse të shkollave në atë vend.

Publikimi i sukseseve të arritura në shkollën shqipe, nëpërmjet organizimit të veprimtarive kulturore-artistike-shkencore të vetë shkollës apo të shkollës në bashkëpunim me prindërit dhe me komunitetin e diasporës të vendit ku jetojnë, do të ndihmonin për zbatimin me sukses të programit të integruar të mësimit shqip në diasporë. Veprimtari, të tilla si: ekspozita me vizatime, veshje, objekte, fotografi, botime e shfaqje publike, olimpiada sportive me lojëra popullore, konkurse të fjalës artistike dhe të muzikës në shqip, panairë të gatimit tradicional, hapje të faqeve internet mbi veprimtaritë e shkollës etj., do të ndihmonin në sensibilizimin e fëmijëve për vlerat e kulturës shqiptare e të mësimit shqip, si dhe për forcimin e lidhjeve ndërmjet tyre dhe komunitetit ku ata jetojnë.

Të gjitha metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies për realizimin e objektivave të programit duhet të shikohen të lidhura dhe në funksion të realizimit të objektivave të gjuhës shqipe dhe letërsisë. Kjo do të thotë se mësuesi dhe autorët e teksteve dhe të materialeve mësimore duhet të studiojnë dhe njohin mirë objektivat e programit në tërësi dhe jo vetëm ato sipas lëndëve përbërëse të tij. Përmbajtja e teksteve duhet të jetë në përputhje me nivelin dhe me objektivat gjuhësore për atë nivel.

Mësuesit dhe hartuesit e tekstit dhe të materialeve mësimore do të gjejnë në fund të këtij Programi rekomandimet për literaturën, e cila do t'u shërbejë për përcaktimin e përmbajtjeve mësimore dhe për realizimin e objektivave të programit.

A. GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Mësimi i gjuhës shqipe si gjuhë amtare ka rëndësi të madhe në zhvillimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve të diasporës. Njohja dhe mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe i ndihmon fëmijët me origjinë shqiptare që të vendosin lidhjet me Atdheun dhe të përvetësojnë më mirë gjuhën e vendit ku jetojnë.

Përmbajtja dhe objektivat e arritjes për gjuhën shqipe dhe letërsinë në programin e integruar të mëimit shqip në diasporë janë hartuar në përputhje me nivelin moshor dhe të mëimit të gjuhës, përcaktuar nga dokumentet evropiane të mëimit të gjuhëve. Materiali mësimor duhet të konceptohet i integruar, në kuptimin që të gjitha përmbajtjet e lëndëve të tjera të jenë në funksion të mëimit të gjuhës shqipe, pasi përvetësimi hap pas hapi i gjuhës shqipe është domosdoshmëri për përvetësimin e njohurive nga fusha të tjera të programit.

Organizimi i tërësive tematike përmes kategorive të komunikimit: *dëgjoj, flas, lexoj* dhe *shkruaj* dhe zbrëthimi i tyre i mëtejshëm ofrojnë mundësi të mira të përvetësimin të njohurive themelore për sistemin e gjuhës shqipe, për tekstet letrare e joletrare, si dhe për formimin e tërësishëm kulturor kombëtar. Është shumë i nevojshëm zbatimi i parimit të ndërvarësisë dhe ndërveprimit në kuadër të fushave mësimore të gramatikës dhe të komunikimit (me gojë dhe me shkrim), letërsisë, teatrit, filmit etj.

Mësimdhënia e kësaj lënde kërkon zotërimin shumë të mirë të gjuhës standarde shqipe nga mësuesit, por dhe zotërimin po aq mirë të gjuhës së vendit ku fëmijët jetojnë. Mësuesi duhet ta dijë përbërjen e klasës së tij, shumëllojshmërinë e dialekteve të shqipes, nivelin e njohjes e të përdorimit të gjuhës shqipe nga nxënësit e tij, si dhe shumëllojshmërinë e të folmeve që zotërojnë ata. Për këtë qëllim, ai duhet të bëjë një vlerësim diagnostik të aftësive gjuhësore të nxënësve, para fillimit të zbatimit të programit. Vlerësimi do ta ndihmojë në përcaktimin e metodave të mësimdhënies dhe të të nxënit sipas nivelit dhe karakteristikave individuale të secilit nxënës.

Rekomandohet që gjuha amtare të pasojë gjuhën e vendit ku jetojnë fëmijët me origjinë shqiptare dhe të kihet kujdes në përdorimin e metodave. Kështu, metodat e mëimit të shkrim-leximit fillestar duhet të harmonizohen-koordinohen me metodat që përdor mësuesi i gjuhës në shkollën që nxënësit ndjekin në vendin ku ata jetojnë. Në këtë plan, është i nevojshëm një bashkëpunim dinamik me mësuesin e gjuhës së vendit pritës, respektivisht ndërtimi i një korrelacioni funksional në mësimin e gjuhës amtare dhe të gjuhës tjetër.

Problem i veçantë është përvetësimi i atyre fonemave e grafemave që e dallojnë gjuhën shqipe nga gjuhët e tjera me alfabet latin. Në fokus të punës së mësuesit të jetë ndërgjegjësimi i nxënësit për fonemat dhe grafemat e gjuhës amtare. Puna e veçantë me tingujt, stërvitjet e vazhdueshme të leximit, zotërimi-pasurimi i fjalësit dhe semantika e fjalës (kuptimi), janë po ashtu fusha që meritojnë kujdes të veçantë, posaçërisht në raport me gjuhën vendore.

Meqenëse praktikisht ekzistojnë vështirësi në mësimdhënien e gjuhës shqipe, metodat me fillim fonosintetik dhe silabik mund të jenë metodat më të përshtatshme në këndvështrimin profesional. Megjithatë, nëse nxënësit kanë paranjohuri të mjaftueshme, mësuesi mund të përdorë dhe metoda të tjera, Gjithsesi, është e nevojshme një shumësi metodash, me një zgjidhje të qëlluar, në raport me kompetencat paraprake të nxënësve dhe me aftësitë e tyre nxënëse.

Për realizimin me efektivitet të objektivave të programit për gjuhën shqipe dhe të letërsisë, mësuesi:

- T'u kërkojë nxënësve të sjellin në klasë përvoja personale, interesa, qëndrime të caktuara ndaj dukurive gjuhësore;

- T'u kërkojë nxënësve të përshtasin një seri rolesh në procesin e të nxënësit (atë të ftuesit në bashkëpunim, dëgjuesit të vëmendshëm, udhëheqësit, mbështetësit, nxitësit, motivuesit, lehtësuesit, vlerësuesit etj);
- Të përdorë rubrika të pasura, paraqitje skemash dhe grafikësh të thjeshtë në procesin mësimor, të tilla si ato që nxënësit hasin në jetën e përditshme, për ta bërë më të natyrshëm integrimin;
- Ta përdorë rimarrjen si një parim didaktik të rëndësishëm në mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e shprehive letrare e gjuhësore;
- Të përdorë lojën si një metodë tërheqëse për nxënësin dhe të efektshme për mësimin e gjuhës;
- T'u japë përparësi ushtrimeve, praktikimit të asaj që nxënësit dinë të bëjnë, larg mbingarkesave teorike, me qëllim që mësimi të mos jetë riprodhues, por nxënësi të aftësohet që të kërkojë, të gjejë, të zbulojë, të zgjidhë, të analizojë, madje të aftësohet edhe për sinteza.
- Të planifikojë veprimtari mësimore, të tilla si: *të folurit në grupe të vogla e të mëdha, të lexuarit shprehës dhe recitimi, të shkruarit, të shkruarit për qëllime të ndryshme dhe në fusha të ndryshme;*
- Të zbatojë punët me shkrim të tipit *ese, shkrim i lirë, përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruarit*, të thjeshta, të paraprira nga njohja, analiza, imitime të krijimeve të së njëjtës natyrë, shkëputur nga trashëgimia letrare shqipe;
- Të zbatojë ushtrime dhe forma pune ndërvepruese;
- Ta pasurojë dhe ta shoqërojë procesin mësimor me *tabela, grafikë, foto dhe skica*, që mbështesin dhe plotësojnë natyrshëm materialin verbal të shkruarit;
- Të bëjë kujdes për shmangien e mbingarkesës mësimore, duke përdorur terminologji të thjeshtuar, në përshtatje me moshën, dhe duke ruajtur sensin e masës në dhënien e koncepteve apo të detyrave mësimore.

Pjesët përfaqësuese nga letërsia shqipe të jenë në përshtatje me moshën e nxënësve dhe të plotësojnë kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe të qartësisë së gjuhës, t'u jepen nxënësve këndshëm, duke e kthyer kohën që fëmija qëndron në shkollë në kohën më të bukur të ditës së tyre.

B. HISTORI

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje me veçoritë e temave të ndryshme mësimore. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave të parashikuar nga programi mësimor.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies dhe të të nxënësve që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren:

- a) **shpjegimi**, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e të nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive e të proceseve historike;
- b) **mësimi zbulues**, nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre;
- c) **biseda**, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të mjaftueshme, që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv apo të jetës familjare, shkollore e sociale të fëmijës;
- d) **diskutimi**, që zgjidh problemin; gjithnjë duhet mbajtur parasysh fakti se përdorimi i shpeshtë i metodave problemore e kërkimore arrin të mënjanojë të mësuarin pasiv e mekanik të nxënësve.
- e) **historia gojore** është një metodë e suksesshme në mësimin e historisë: ajo përqendrohet në rrëfenjat dhe në dëshmitë e personazheve të gjalla të ngjarjeve të ndryshme historike.
- f) **ekskursionet dhe vizitat tematike** në Atdhe janë metoda të pëlqyera nga nxënësit, që ndihmojnë konkretisht në njohjen e vlerave me rëndësi historike të vendit.

Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, që janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme apo tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta etj.

Përdorimi i metodave dhe i teknikave ndërvepruese, që nxisin të menduarin kritik dhe krijues, i shërben zhvillimit të kompetencave për fushat e mëposhtme:

1) *Gjerësia dhe thellësia e njohurive historike*

Nxënësit:

- Përshkruajnë dhe shpjegojnë në mënyrë të thjeshtë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike të përfshira në program, si: truall historik, tradita historike, civilizim, globalizëm etj.;
- Përdorin fjalorin e duhur në përputhje me përmbajtjen e programit;
- Shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike në situata të ndryshme dhe gjurmët që ato kanë lënë në historinë e popullit shqiptar;
- Vlerësojnë rolin që kanë ata dhe familja e tyre në përcjelljen e gjuhës, traditave dhe historisë së tyre brez pas brezi;
- Analizojnë raportin e tyre si qytetarë të vendit ku jetojnë dhe lidhjet me vendin amë;
- Kuptojnë detyrimet dhe përgjegjësitë në kuadrin e shtetit ligjor, mbrojtjes së të drejtave të individit, nëpërmjet pajisjes me kulturë demokratike.

2) *Interpretimi historik*

Nxënësit:

- Tregojnë se, për ngjarje, procese e figura të ndryshme historike, ka interpretime të ndryshme;
- Analizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike;
- Arrijnë në kompromise për probleme të caktuara;
- Interpretojnë tablo, foto, harta historike etj., për ngjarje, fakte ose dukuri historike të përfshira në tekste, në mjetet didaktike ndihmëse dhe në literaturën historike;
- Argumentojnë pikëpamjet e tyre, duke nxjerrë konkluzionet përkatëse për ngjarjet, figurat, faktet apo dukuritë historike të studiuara.

3) *Kërkimi historik*

Nxënësit:

- Përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo, harta historike, për aspekte të ndryshme të periudhave historike të studiuara;
- Bëjnë pyetje në funksion të grumbullimit të informacionit të duhur për çështje të ndryshme të përfshira në studim;
- Hulumtojnë për të grumbulluar informacione nga burime të ndryshme historike të dorës së parë dhe të dytë (harta, materiale të shkruara, ilustrime të ndryshme etj.), në funksion të çështjeve të përfshira në mësim.

4) *Organizimi dhe komunikimi*

Nxënësit:

- Përzgjedhin dhe rendisin në mënyrë logjike të dhënat dhe konceptet më të rëndësishme historike për vendet dhe periudhat e studiuara;
- Komunikojnë për njohuritë dhe për të kuptuarit e periudhave historike të studiuara, duke përdorur për këtë qëllim teknika të ndryshme, si përshkrimin, shpjegimin, etj.;
- Marrin pjesë në debate ku, nëpërmjet njohurive dhe aftësive të fituara, kontribuojnë në arritjen e kompromiseve për probleme të caktuara.

Të gjitha metodat, teknikat dhe teknologjitë e mësimdhënies për realizimin e objektivave të historisë duhet të shikohen të lidhura dhe në funksion të realizimit të objektivave të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Kjo do të thotë që mësuesi dhe autorët e teksteve dhe të materialeve mësimore duhet të studiojnë dhe njohin mirë objektivat e programit në tërësi dhe jo vetëm ato sipas “lëndëve” përbërëse të tij. Përmbajtja e teksteve duhet të jetë në përputhje me nivelin dhe me objektivat gjuhësore për atë nivel.

C. GJEOGRAFI

Formimi gjeografik, në kuadër të programit të integruar të mësimit shqip për nxënësit e diasporës, zë një vend të rëndësishëm, krahas gjuhës shqipe dhe letërsisë, historisë, trashëgimisë. Ky formim ndihmon si në njohjen e viseve shqiptare me natyrën e tyre të veçantë, veçoritë e popullimit dhe të zhvillimit ekonomik, ashtu dhe në analizën e faktorëve, shkaqeve dhe pasojave që kanë ndikuar në transformimin e mjedisit natyror dhe në zhvillimin social e ekonomik të vendit.

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit për realizimin e këtij formimi duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjet mësimore, por edhe me nivelin e nxënësve, me gjendjen e bazës didaktike etj.

Ndër këto metoda mësimdhënieje, mund të propozojmë:

- a) **Përshkrimi**, sidomos kur pasurohet me elemente artistike, mund të përdoret në shtjellimin e veçorive fiziko-gjeografike, duke ndikuar kështu në formimin e përfytyrimeve të qarta të kujtesës dhe të imagjinatës;
- b) **Biseda** do të ishte më e efektshme për ato tema për të cilat nxënësit kanë njohuri paraprake të mjaftueshme, që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv;
- c) **Shpjegimi**, si metodë me hapësirë tepër të gjerë përdorimi, mund të përdoret me sukses në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve, që synojnë të kuptuarit e thelbit, të shkakut ose, me fjalë të tjera, të origjinës së objekteve, dukurive e proceseve gjeografike dhe, rrjedhimisht, të formimit të koncepteve të sakta e të qëndrueshme për to;
- d) Mjaft rezultate janë edhe metodat **problemore, gjysmëkërkimore e kërkimore**, vrojtimit, intervistat, anketimet, seleksionimi e analiza e të dhënave, përpilimi i modeleve të planeve dhe hartave tematike etj. Këto metoda mund të përdoren në ato raste kur nxënësit, në mënyrë individuale ose të organizuar në grupe, ndërmarrin, me ndihmën dhe nën drejtimin e mësuesit, veprimtari që synojnë zgjidhjen e problemeve të thjeshta të organizimit racional të hapësirës së afërt e të mesme, të mbrojtjes së mjedisit etj.

Rëndësi të veçantë në formimin gjeografik zë përdorimi i mjeteve të ndryshme mësimore, si: *globi dhe hartat, tabelat, skicat, diagramat, CD-të, kompjuteri, interneti etj.* Një gjë e tillë e bën tërheqës e konkret mësimin e gjeografisë, si dhe nxit punën e pavarur hulumtuese të nxënësve.

Një element i domosdoshëm në gjeografi është *ekskursioni* apo ekspedita në terren. Prandaj edhe për nxënësit e diasporës rekomandohet organizimi, me qëllim njohës dhe edukativ, i ekskursioneve dhe i ekspeditave në viset e ndryshme shqiptare. Kjo do të ndihmonte jo vetëm në njohjen e natyrës, të popullsisë dhe të ekonomisë të trevave shqiptare, por edhe në krahasimin e veçorive dhe të tipareve të tyre me vendet ku jetojnë nxënësit e diasporës.

Dhënia e dijeve që i përkasin lëndës së gjeografisë realizohet si nëpërmjet shkrirjes së njohurive me disipinat e tjera (gjuhën shqipe dhe letërsinë, historinë, trashëgiminë), ashtu edhe nëpërmjet zhvillimit të temave të mirëfillta gjeografike që kanë të bëjnë me: pozicionin gjeografik të trevave shqiptare; veçoritë e relievit, klimës, ujërave, botës bimore e shtazore; organizimin administrativ; tipet e vendbanimeve; ecurinë e numrit, shpërndarjes dhe migrimet e popullsisë; zhvillimin e sektorëve të ekonomisë etj. Këto njohuri vijnë duke u shtuar dhe thelluar, duke filluar nga nivelet më të ulëta drejt atyre më të larta, sipas tematikave të mësipërme.

Të gjitha metodat, teknikat dhe teknologjitë e mësimdhënies për realizimin e objektivave të gjeografisë duhet të shikohen të lidhura dhe në funksion të realizimit të objektivave të gjuhës shqipe dhe letërsisë. Kjo do të thotë që mësuesi dhe autorët e teksteve dhe të materialeve mësimore duhet të studiojnë dhe të njohin mirë objektivat e programit në tërësi dhe jo vetëm ato sipas “lëndëve” përbërëse të tij. Përmbajtja e teksteve duhet të jetë në përputhje me nivelin dhe me objektivat gjuhësore për atë nivel.

D. TRASHËGIMI

Lënda “Trashëgimi” i kushtohet njohjes së vlerave të veçanta humane dhe natyrore të Atdheut në shekuj. Realizimi i objektivave të kësaj lënde brenda programit të integruar të mësimin shqip në diasporë ndihmon fuqimisht formimin dhe edukimin qytetar të brezit të ri, i cili duhet të njohë, të respektojë, të dojë, të mbrojë dhe të pasurojë vazhdimisht vlerat më të spikatura të kulturës dhe të natyrës së vendit të origjinës, pavarësisht vendit ku jeton.

Objektivat e trashëgimisë në programin mësimor integrojnë objektiva të historisë, gjeografisë, gjuhës dhe letërsisë, edukimit muzikor, teknologjisë, arteve figurative, arkitekturës, antropologjisë etj.

Programi i integruar i mësimin shqip në diasporë synon t’i kundërvihet një tendence të vërejtur të rrafshimit të vlerave kombëtare, të zbehjes apo edhe të humbjes së tipareve të caktuara të identitetit natyror, kulturor e shpirtëror kombëtar, tendencë e cila është rezultat i zhvillimeve të sotme në botë, i globalizimit ekonomik e kulturor.

Me njohjen dhe me vlerësimin e vlerave të veçanta natyrore dhe të kulturës kombëtare, me trajtesat emocionuese të bukurisë dhe të larmisë së jashtëzakonshme të monumenteve të natyrës dhe të kulturës, programi ndihmon në formimin e fëmijëve dhe të rinjve me këto vlera, në forcimin e identitetit kombëtar, në vendosjen e raporteve të drejta ndërmjet identitetit kombëtar dhe atij si qytetar i gjithë botës.

Nga klasa e parë deri në të nëntën, ku është vënë në fokus trashëgimia kombëtare, krijohen mundësi ballafaqimi me trashëgiminë botërore, duke zbuluar pasurinë që vjen nga diversiteti natyror dhe kulturor, si dhe ndikimet reciproke të trashëgimisë kombëtare dhe asaj botërore te njëra-tjetra. Njëherazi, në këtë kontekst, programi krijon mundësinë e njohjes së rrugëve të vlerësimit dhe të mbrojtjes prej rrezikut të dëmtimit e të humbjes së identitetit natyror, kulturor e shpirtëror kombëtar.

Metodat bazë të mësimdhënies janë: **kërkimi, biseda, ekspedita, veprimtaritë praktike** etj. Veprimtari, të tilla dhe të nxënësve si: ekspozita me vizatime, veshje, objekte, fotografi, botime e shfaqje publike, olimpiada sportive me lojëra popullore, konkurse të fjalës artistike dhe të muzikës në shqip, panairë të gatimit tradicional, hapje të faqeve në internet mbi veprimtaritë e shkollës etj., do të ndihmonin në sensibilizimin e fëmijëve për vlerat e kulturës shqiptare e të mësimin shqip, si dhe do të forconin e lidhjet ndërmjet tyre dhe komunitetit ku ata jetojnë.

Si mjete të përshtatshme të mësimdhënies mund të shërbejnë CD-të, DVD-të, albumet, posterat dhe materiale të tjera mbi trashëgiminë kulturore e natyrore të Atdheut, të rekomanduara apo të gjetura nga vetë nxënësit.

Mësuesi duhet të ketë parasysh që në realizimin e objektivave të programit ndihmon dhe përgatitja e nxënësve në lëndët e arteve, në shkollat e ndjekura në vendin ku ata jetojnë. Kështu, p.sh., gjatë shpjegimit dhe përdorimit të instrumenteve popullore shqiptare, si: fyell, dajre, çifteli, gërrenjëza, daulle të vogla, bilbil etj., mësuesi duhet të marrë parasysh njohjen dhe nivelin e zotërimit të instrumenteve të ndryshme nga fëmijët.

Bashkëpunimi me familjet dhe komunitetin shqiptar ka një rol të rëndësishëm në realizimin e këtij programi. Përvojat individuale dhe shoqërore mund të prezantohen në orë mësimi ose në takime të përbashkëta përkujtimore apo të qëllimshme. Ky bashkëpunim ndihmon në zhvillimin dhe në ruajtjen e identitetit kombëtar të fëmijëve.

Të gjitha metodat, teknikat dhe teknologjitë e mësimdhënies për realizimin e objektivave të trashëgimisë duhet të shikohen të lidhura dhe në funksion të realizimit të objektivave të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Kjo do të thotë që mësuesi dhe autorët e teksteve dhe të materialeve mësimore duhet të studiojnë dhe njohin mirë objektivat e programit në tërësi dhe jo vetëm ato sipas lëndëve përbërëse të tij. Përmbajtja e teksteve duhet të jetë në përputhje me nivelin dhe me objektivat gjuhësore për atë nivel. Sugjerohet që zhvillimi i

përmbajtjeve mësimore të realizohet sipas rrethanave shkollore vendore dhe në varësi të tyre.

8. VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Ai ka për qëllim:

- të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe mundësitë e nxënësve;
- të vlerësojnë metodën e mësimdhënies dhe të nxënësve;
- t'u tregojnë nxënësve dhe prindërve nëse janë arritur objektivat.

Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Vlerësimi i nxënësve ndahet në tre tipa kryesorë:

- 1) **Diagnostik**, që zakonisht kryhet në fillim të vitit mësimor ose të kapitullit, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve. Vlerësimi diagnostik mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, nuk shënohet në regjistër (joformal) dhe mund të bëhet me gojë. Pyetjet që mësuesi planifikon, kanë të bëjnë pikërisht me këtë lloj vlerësimi dhe shërbejnë për të gjitha objektivat e kapitujve.
- 2) **Formues**, që është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoret për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vlerësimi me notë i nxënësit.
- 3) **Përmbledhës**, që kryhet më shpesh në fund të një kapitulli, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe. Vlerësimet përmbledhëse përdoren kryesisht për t'u raportuar progresin e nxënësve në lidhje me kurrikulën vetë nxënësve, si dhe prindërve e mësuesve, por edhe për të modifikuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehjet, po edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët në veçanti.

Vlerësimi mund të jetë gojor, me shkrim ose i ndërthurur. Format e vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për ata.

Vlerësimi me gojë, përveç kontrollit të përvetësimit të njohurive, i shërben zhvillimit të disa aftësive të domosdoshme për jetën, si aftësia e të shprehurit, të komunikuarit para një auditori etj. Programi nuk e kushtëzon mësuesin të jetë rigoroz në vlerësimin e nxënësve në çdo orë mësimi, por i krijon mundësi mësuesit ta vlerësojë nxënësin në vijueshmëri, në ecurinë e tij.

Vlerësimi me shkrim përfshin një mori formash, që në një masë të konsiderueshme janë specifike për secilën përmbajtje mësimore. Ai mund të realizohet nëpërmjet teknikave dhe instrumenteve të ndryshme, si: *veprimtari praktike, testim, ese, projekt, portofol, album, vizatim, fotografi* etj. Njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit plotësohet më tej edhe nga shënimet e vetë mësuesit. Mësuesi duhet sistematikisht t'i japë mundësinë çdo nxënësi që të vlerësohet për parashtrimet e tij me shkrim.

Prezantimet mund të shoqërojnë detyrat me shkrim dhe mund të përdoren për vlerësime përmbledhëse në fund të një njësie, kapitulli, si dhe mund të shoqërojnë një raport të shkruar si pjesë e një projekti të madh. Këto prezantime mund të jenë pjesë e portofolit të nxënësit, në formë të shkruar apo elektronike. Mundësia e përdorimit në tema të caktuara të projekteve, në grupe apo individualisht, i krijon mundësi mësuesit të vlerësojë imagjinatën dhe mendimin krijues të nxënësve.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit mësimor. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekt, fotografi, vizatime, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, hartime, poezi etj. Portofoli i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij, gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi rekomandon.

Mësuesi vlerëson shkallën dhe dinamikën e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor. Ai vlerëson gjithashtu ballafaqimin dhe forcën argumentuese të nxënësve për një çështje të diskutueshme ose të debatueshme, mbajtjen qëndrim ndaj një ngjarjeje apo figure të shquar, përdorimin e burimeve alternative të të nxënësve.

Kriter vlerësimi për nxënësit është dhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike etj. Mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të punuar në grup dhe për të vlerësuar punën e anëtarëve të tjerë të grupit. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Vlerësimi i nxënësit është cilësor, që do të thotë se nota është përshkruese, sipas katër niveleve:

Niveli A: shumë i mirë

Niveli B: i mirë

Niveli C: i mjaftueshëm

Niveli D: i pamjaftueshëm.

Notat regjistrohen në regjistrin personal të mësuesit dhe u njoftohen nxënësve dhe prindërve të tyre. Në përfundim të programit, nxënësve u jepet një dëftesë, ku shënohet nota e nxënësit në përfundim të programit, për një nivel të caktuar.

Nxënësve mund t'u shënohet kjo notë në dokumentacionin e shkollës së tyre të rregullt, në përputhje me ligjet vendase.

9. PLANI MËSIMOR

Programi i integruar i mësimi shqip në diasporë është hartuar për t'u zbatuar sipas planit mësimor të mëposhtëm. Megjithatë, në varësi të kushteve të zhvillimit, ai pranon fleksibilitet në zbatimin e tij.

Nr.	Lëndët-fushat mësimore	Numri vjetor i orëve sipas niveleve		
		Niveli i parë Klasat I-III	Niveli i dytë Klasat IV-VI	Niveli i tretë Klasat VII-IX
1	Gjuhë dhe letërsi shqipe	48	48	48
2	Histori	4	8	8
3	Gjeografi	4	7	7
4	Trashëgimi	20	13	13
	Gjithsej	76	76	76

10. BURIME TË REKOMANDUARA TË TË NXËNIT

Si burime të rekomanduara të të nxënit, konsiderohen:

- Tekstet dhe mjetet e tjera mësimore që do të hartohen në bazë të këtij programi.
- Tekstet, mjetet mësimore dhe literatura ndihmëse, sipas niveleve dhe grupmoshave të këtij programi, që përdoren në Shqipëri (klasat 1-9), të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.
- CD, fotografi, postera e mjete të tjera ilustruese për trevat shqiptare.

për grupin e punës

KRYETARI

Prof. Dr. Ardian MARASHI